‘Trashëgimia është pjesë e ndërtimit të jetës së njerëzve, aspiratat e ndërgjegjshme ose të pandërgjegjshme zenë vend dhe të siguron shenja të vazhdimësisë, ikonat e identitetit dhe vendet që të dhurojnë kënaqësi, gëzim dhe ndriçim në botën shpejtë-ndryshuese të komunikimit global’ *‘Në strukturën e saj të parë trashëgimia është thjesht mjedisi i ndërtuar, natyror dhe kulturor i një territori’* (Millar 2005).

Millar (1995) tregon se eksperiencia e trashëgimisë është e ndryshme dhe unike për çdo person. Millar (2000) vendos se trashëgimia *‘është një kuptim i përkatësisë dhe vazhdimësisë që është e ndryshme për çdo person duke theksuar se:*

‘Në strukturën e saj trashëgimia është thjesht

mjedisi i ndërtuar, natyror dhe kulturor i një territori” (Millar 2005)

Trashëgimia kulturore është themeli i identitetit të një kombi dhe një burim i rëndësishëm për turizmin në botë. Kultura është përdorur shpesh në sensin e përditshëm si “menyrë e jetesës” apo “shprehëse e artit”. Sipas antropologut Edwart Burnett Tylor (1871) “*kultura është një tërësi komplekse që përfshin njohuritë, besimin, artin, parimet, ligjin, zakonet, dhe gjithçka tjetër të krijuar nga aftësitë e njeriut si anëtar i shoqërisë*”.

Ndërsa sipas Godman dhe Marx (1978) “*kultura është një trashëgimi e mësuar, shoqërisht e transmetuar e objekteve, njohurive, besimit, vlerave dhe pritshmërive normative, që i mbartin anëtarët e një shoqërie për t’u përballur me probleme të përsëritura*”²⁰

Me nënshkrimin e Kartës së Venecia në 1964, u dhanë disa rekomandime në lidhje me përcaktimin e konceptit të trashëgimisë kulturore.

Sipas Nenit 1 të Konventës së Unesco-s, *trashëgimi kulturore* konsiderohen:

- *Monumentet*; veprat arkitekturore, veprat skulpturore dhe të pikturuara, elementet apo strukturat me natyrë arkeologjike, mbishkrimet, vendbanimet shpellore dhe kombinime të elementeve, të cilët kanë vlera universale nga këndvështrimi i historisë, artit dhe shkencës.
- *Grupe ndërtesash të ndara ose të bashkuara*, të cilat për shkak të arkitekturës së tyre, homogjenitetit apo vendit që zënë në mjedis, kanë vlera të jashtëzakonshme universale nga këndvështrimi i historisë, artit dhe shkencës.
- *Sitet*, veprat e njeriut ose veprat e kombinuara të njeriut dhe natyrës, zonat që përfshijnë vende arkeologjike, të cilat janë me vlera universale nga këndvështrimi historik, estetik, etnologjik dhe antropologjik.

Sipas nenit 4 të kësaj Konvente “*Trashëgimia është detyra për të siguruar identifikimin, mbrojtjen, konservimin, prezantimin dhe trasmetimin në brezat e ardhshëm të trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore*”. Sipas studjueses japoneze Loulanski (2006): “*Trashëgimia kulturore përfshin aspekte të kulturës material -site, ndërtesa, peisazhe, monumente dhe objekte ashtu si dhe aspekte të kulturës jomateriale (shpirtërore) të mishëruara në praktikat sociale, jetën e komunitetit, vlerat, besimet, dhe format shprehëse si gjuha, artet, zejtarinë, muzika dhe vallet. Sipas saj, koncepti i trashëgimisë po evoluon, si rezultat dhe në përputhje me qëndrimet, nevojat dhe kërkesat e njerëzve drej saj*”.

Collin Michael Hall dhe McArthur, identifikojnë katër vlera kryesore të trashëgimisë:

- *Vlera ekonomike*, të cilat lidhen me gjenerimin e të ardhurave që përfiton një territor si rezultat i shfrytëzimit të trashëgimisë, për qëllime të ndryshme, përfshirë dhe turizmin dhe rekreacionin;
- *Vlera sociale dhe kulturore*, bazuar në lidhjen shpirtërore që ekziston mes individit dhe identitetin e tij kombëtar;
- *Vlera shkencore dhe edukative*, të cilat shprehen me trasmetimin dhe ruajtjen e vlerave kluturore nëpër breza;
- *Vlera politike*, si funksion i qëndrimit nga ana e politikanëve dhe përdorimit të trashëgimisë si mjet promovimi të historis dhe identitetin kombëtar.²¹

²⁰United Nations Educational Scientific and Culture Organization

2.3.2.1 Trashëgimia kulturore

Uzzel (1989) thekson se interpretimi i trashëgimisë ka qenë tradicionalisht e dominuar vetëm nga një qasje të bazuar në burime (Ashworth dhe Larkam 1994; Millar 1989; Nuryanti 1996) duke u përqëndruar në përcaktimin e materialeve dhe komponentëve jo-materiale të kulturës dhe trashëgimisë.

Në Konventën e UNESCO-s në vitin 2003, trashëgimia jomateriale u përcaktua si:

“Praktikat, përfaqësimet, shprehjet, njohuritë, zotësitë, ashtu sikurse instrumentet, objektet, zonat kulturore së bashku me komunitetet, grupet dhe individët si pjesë e trashëgimisë kulturore të tyre. Kjo trashëgimi kulturore jo materiale e trasmetuar brez pas brezi është krijuar nga komunitetet përgjegjës për mjedisin e tyre, si lidhje e natyrës me historinë duke u siguruar atyre identitetin dhe vazhdimësinë ashtu sikurse promovimin e respektit për diversitetin kulturor dhe krijimtarinë njerëzore²².

2.3.2.2 Qytetet e trashëgimisë kulturore

Përkufizimi i turizmit të trashëgimisë ka rezultuar në interpretime të shumta të veçanta të konceptit dhe ka çuar në keq interpretim dhe polemika në literaturë (Garrod dhe Fyall 2000). Debatimi i rrënjësor nëse konsumi duhet të mendohet më tepër nga ana ofertës-apo qasja nga ana e kërkesës i ka okupuar shumë analistët në fushën e trashëgimisë.

Poria (2000), Butler (2001) dhe Airey (2005) pretendojnë se turizmi i trashëgimisë duhet të qartësohet përmes ‘motivimit dhe perceptimit’ të konsumatorëve në lidhje me karakteristikat specifike të eksperiencës së trashëgimisë, dhe perceptimit të konsumatorëve për trashëgiminë personale e cila ka të ngjarë të jetë një kombinim i të dy trashëgimive botërore dhe lokale ose trashëgimisë kombëtare (Boniface dhe Foëler 1993).

Poria, Butler dhe Airey (2001) për këtë arsye e përcaktojnë **turizmin e trashëgimisë** si:

“një nëngrup i turizmit në të cilin motivimi për të vizituar një vend është i bazuar në atributet e tij historike”.

Në përputhje me autorë të tjerë (Poria 2001; Richards 1996; Silverberg 1995; Moscardo 2001; Timothy 1996) Ashworth dhe Tunbridge (1996) argumentojnë se konsumi i trashëgimisë ekziston më tepër në interpretimin e tij se në burimet e tij. Produkte të ndryshme mund të krijohen nëpërmjet interpretimeve të ndryshme të burimeve të njëjta. Për këtë arsye, burimet e trashëgimisë mund të shfrytëzohen dhe të shiten pothuajse në mënyrë të pakufizuar, interpretohen në mënyra të ndryshme dhe në tregje të ndryshme (Ashworth 1996; Millar 1995). Për më tepër, përkufizimi i anës së kërkesës i propozuar nga Poria, Butler dhe Airey (2000) nënkupton se *motivimi turistik është i bazuar në karakteristikat e trashëgimisë*.

Nuk ekziston asnjë koncept i qartë për menaxhimin e turizmit në qytetet historike. Çdo qytet menaxhohet në mënyrë të veçantë pavarësisht nga ekuivalenca në klimën gjeopolitike dhe urbane (Ashworth & Tunbridge 2000, 1990). Maitland (2005) vëren se vendosja e strategjive të menaxhimit në qytetet turistike-historike ka inicuar vetëm kohët e fundit. Në mënyrë për ta bërë turizmin e trashëgimisë në qytete një biznes fitimprurës dhe të qëndrueshëm, duke siguruar një përjetim optimal të vizitorëve pa përkeqësuar cilësinë e jetës së popullatës lokale, planifikimi integruar i ardhshëm do të jetë çështje vendimtare (Page 1995; Ashworth dhe Tunbridge 2000; Orbasli 2000).

Richards (1996) vë në dukje se shumë politika turistike supozojnë se turistëve mund t'i shërbehet me një *'produkt të përgjithësuar kulturor apo trashëgimi'* duke pasur parasysh se në thelb çdo destinacion ndoshta mund të zhvillohet për turizëm. Russo dhe Van der Borg (2002) shprehin se *planifikuesit e qytetit duhet të përqëndrohen më tepër në elementet jo-materiale të produktit të turizmit që prej këtyre elementeve jo-materiale të bëjnë një ndryshim të rëndësishëm në atraktivitetin e një destinacioni.*

Turisti i trashëgimisë

Në literaturë, nga studiues të ndryshëm apo përcaktimet nga organizmat ndërkombëtar të fushës së turizmit dhe trashëgimisë, përdoren *termat turizëm kulturor dhe turizëm i trashëgimisë* (culture/heritage tourism). Pavarësisht këtij përcaktimi kultura si koncept është gjithë përfshirëse.

Organizata Botërore e Turizmit (WTO) e përkufizon turizmin si: *“aktivitetet e individëve gjatë udhëtimit dhe qëndrimit të tyre në një vend jashtë vendit të zakonshëm të banimit, në një periudhë më pak se një vit, për kalimin e kohës së lirë, biznes apo qëllime të tjera”*.

Ndërsa sipas Organizatës Europiane të Turizmit dhe Kalimit të kohës së Lirë (ATLAS)²³ turizmi kulturor është *“lëvizja e njerëzve drejt atraksioneve kulturore, larg prej vendit tyre të banimit, me qëllim mbledhjen e informacioneve dhe eksperiencave për të kënaqur nevojat e tyre kulturore”*

Megjithatë përkufizimi i turizmit të trashëgimisë ka rezultuar në interpretime të shumta të veçanta të konceptit dhe ka çuar në keq interpretim dhe në polemika në literaturë (Garrod dhe Fyall 2000). Turizmi kulturor nuk është vetëm turizmi i trashëgimisë kulturore. Turizmi kulturor punon si një rrjet sepse përfshin lloje të artit nga teatri, vallja esetë etj. Debati i rrënjësor nëse konsumi duhet të mendohet më tepër nga ana ofertës-apo qasja nga ana e kërkesës i ka okupuar shumë analistët në fushën e trashëgimisë. Poria (2000), Butler (2001) dhe Airey kritikojnë vlerësimin e trashëgimisë nga perspektiva e *'pasurisë trashëgimore'* si cilësi themelore e trashëgimisë në pronat historike të tërheqjes (Garrod dhe Fyall 2000). Ata pretendojnë se turizmi i trashëgimisë duhet të qartësohet përmes *'motivimit dhe perceptimit'* të konsumatorëve në lidhje me karakteristikat specifike të eksperiencës së trashëgimisë, dhe perceptimit të konsumatorëve për trashëgiminë personale e cila ka të ngjarë të jetë një kombinim i të dy trashëgimive botërore dhe lokale ose trashëgimisë kombëtare (Boniface dhe Foëler 1993).

Poria, Butler dhe Airey (2001) për këtë arsye e përcaktojnë **turizmin e trashëgimisë** si:

“një nëngrup i turizmit në të cilin motivimi për të vizituar një vend është i bazuar në atributet e tij historike”

Poria (2000) i ka klasifikuar turistët e trashëgimisë në tri kategori:

- *Në bazë të statusit të trashëgimisë të vendeve të vizituara;*
- *Në lidhje me vetëdijen e vizitorit të këtij statusi dhe lidhja me sitet*
- *Në lidhje me trashëgiminë personale të vizitorit.*

Në vitet tetëdhjetë dhe nëntëdhjetë turizmi i trashëgimisë është quajtur një produkt i ri në kërkesën e konsumatorit. *Turizmi i trashëgimisë* konsiderohej si një mundësi jetike për planifikimin e autoriteteve për të zhvilluar territoret në dhe atraktivitetet Hewison (1987). Poria, Butler dhe Airey (2000, 2001 A, 2003) kundërshtojnë vlerësimin e trashëgimisë nga perspektiva e ‘pasurisë trashëgimore’ si cilësi themelore e trashëgimisë në pronat historike të tërheqjes (Garrod dhe Fyall 2000). Ashworth dhe Tunbridge (2000) argumentojnë se oferta e trashëgimisë dhe e atraksioneve historike nuk duhet të interpretohet thjesht si një përgjigje ndaj kërkesës konsumatore post-moderne por të vlerësohet duke marrë parasysh nevoja më të gjera sociale. Gjithsesi ekziston perceptimi i turistëve se vizita në destinacione të ndryshme është e dobishme (Mill dhe Morrison, 1998; Tidewell dhe Faulkner, 1999), pasi mund ta shohi si mundësi argëtimi por dhe ku niveli i pasigurisë është relativisht i vogël (Lue, 1993; Tidewell dhe Faulkner, 1999). Megjithatë, një ndryshim mund të vërehet në drejtim të integritetit të turistëve’ ekuilibri i nevojave dhe motiveve (Richards, 1996; Moscardo 2001; Poria, Butler dhe Airey 2003;; Silverberg 1995; Millar 1995).

Duke vizituar destinacione të ndryshme, turistët përfitojnë më tepër eksperiencë dhe kanë premisa për të shtuar konsumin (Murray & Graham, 1997) duke ndikuar në kënaqjen e kërkesave individuale apo të tyre heterogjene (Lue, 1993). Vetë udhëtimet në shumë destinacione në të njëjtën kohë e sidomos ato të trashëgimisë kulturore, janë të lidhura me racionalizimin ekonomik; ato janë perceptuar për të kursyer kohë dhe para lidhur me këtë udhëtim (Lue, 1993). Kjo përvojë në lundrim krijon tek klientët besimin dhe perceptimin se, në qoftë se ata do të vizitonin këto vende “një nga një”, kjo do t’u kushtonte më tepër si në kohë ashtu edhe në mjete monetare (Mancini, 1999).

2.3.2.3 Menaxhimi i pasurisë së trashëgimisë kulturore

Nuk ekziston asnjë koncept i qartë për menaxhimin e turizmit në qytetet historike. Çdo qytet menaxhohet në mënyrë të veçantë pavarësisht nga ekuivalenca në klimën gjeopolitike dhe urbane (Ashworth dhe Tunbridge 2000). Trashëgimia kulturore gjithnjë e më tepër po njihet si e mirë publike dhe përfitimet e saj shihen si përfitime ndërkombëtare. Përfitimet ekonomike përfshijnë si reduktimin e varfërisë dhe krijimit të vendeve të punës, por edhe nëpërmjet ndërtimit, turizmit, artit dhe produkteve artizanate, apo bizneseve të ndryshme me natyrë turistike.

Mirëmenaxhimi konsiderohet si çelësi i suksesit për trashëgiminë kulturore duke i rritur dhe vlerat me kalimin e kohës dhe siguruar më tepër përfitime, duke u bërë gjithmonë *një vlerë e shtuar*, ndërkohë që pasuria ruhet në mënyrë efektive.

Van der Borg (1996) duke vërtetuar 7 qytete me trashëgimi, të cilat kishin nevojë urgjente për zhvillimin e sektorit turistik, vëren se vetëm një prej tyre ishte zbatuar një politikë strategjike për

turizmin bazuar dhe në karakterin ciklik të teorisë së Butler (1980). Teoria e ciklit të jetës së destinacionit, fillimisht përshkruan Butler (1980), është aplikuar në mjedisin e turizmit të trashëgimisë urbane i cili do të hartojë zhvillimet e mundshme dhe të përcaktojë veprimet e nevojshme të menaxhimit.

Richards (1996) vuri në dukje se shumë politika turistike supozojnë se turistëve mund t'i shërbehet me një *'produkt të përgjithësuar kulturor apo trashëgimi'* duke pasur parasysh se në thelb çdo destinacion ndoshta mund të zhvillohet për turizëm.

Orbasli (2000) thekson se planifikimi i qëndrueshëm i zhvillimit të turizmit në qytetet historike ka rëndësi të madhe. Sipas tij, komponentët e industrisë së turizmit lokal janë të organizuara në hapësirë sipas natyrës së tyre, ndërsa, grupimi (clustering) i atraksioneve historike dhe kulturore në pjesë të kufizuara të hapësirës urbane është pasojë tipike e evolimit historik të qendrave europiane.

2.3.2.4 Planifikimi për menaxhimin e trashëgimisë kulturore

Nga multiplikatorët të kapacitetet mbajtëse social-ekonomike dhe ciklet e jetës

Ndikimet ekonomike të turizmit vlerësohen normalisht përmes analizave të multiplikatorit. Kjo teknikë analitike ka të bëjë me "mënyrën në të cilën shpenzimet e turizmit filtrohen sido që është ekonomia" (Pearce 1989). Sa më e lartë pjesa e të mirave turistike që janë të prodhuara në vend, aq më i lartë multiplikatori. Nga ana tjetër, në qoftë se ekonomia lokale është strukturalisht një ekonomi importi, multiplikatorët turistikë do të jenë më të ulët.

Në destinacionin e trashëgimisë, ndërsa produkti kryesor është i palëvizshëm, për shkak të natyrës së tyre të pa-riprodhueshme, aktivitetet komplementare janë të lira të vendosen në një "rajon turistik" të gjerë. Rajonet turistike mund të përcaktohen si zona të përfshira në funksion të turistit, në një destinacion të caktuar. Kjo nënkupton që çdo qytet me trashëgimi kulturore ka rajonin e vet turistik, pak a shumë ekstensiv. Miossec (1976) analizon rritjen e turizmit në rajone, duke identifikuar modele tipike. Në analizën e tij, qendra e qytetit me trashëgimi, ndryshon nga periferia e tij në termat e funksioneve. Arsyeja e udhëtimit është epiqendra e fluksit të vizitorëve; megjithatë ajo merr vetëm një pjesë të fluksit financiar që përfshihet në aktivitet.

Në praktikë brenda rajoneve turistike, modelet e lidhjeve dhe lëvizjeve janë të ndërthurura dhe komplekse. Për shembull, ekzistenca e një destinacioni tjetër në afërsi, përcakton një "ndarje" të fluksit të vizitorëve, me turistët që i vizitojnë të dyja qytetet, dhe që e kalojnë natën në njërin apo të dy qytetet.

Zhvillimi i rajonit turistik mbetet në një farë "vakumi shkencor", për të cilin Cazes dhe Portier (1996) atribuan në vështirësinë e krijimit të kufijve disiplinorë në studimin e fenomeneve të lidhura dhe me qëndrueshmërinë.

Qëndrueshmëria është tipar sistemesh që të rriten e vetëshumohen, duke u përshtatur dhe zhvilluar si pasojë e dëmeve dhe bashkëveprimeve (e mbase konflikteve) të brendshme midis pjesëve të saj përbërëse.


Raporti i njohur i Brundland ²⁴ sjell këtë përkufizim të zhvillimit të qëndrueshëm:

“zhvillimi i qëndrueshëm është ai lloj zhvillimi që i përshtatet nevojave të brezit ekzistues pa dëmtuar kapacitetin e brezave të ardhshëm të plotësojnë nevojat e tyre”

Turizmi kulturor i cili përcaktohet nga Richards (1996) si “konsumi i artit, trashëgimisë, folkut, dhe një mori shfaqesh kulturore nga turistët”, është një sektor në zhvillim i tregut të vizitorëve. Ndryshe nga veprimtari të tjera të kohës së lirë, ai duket se ka tiparet më të preferuara për një qytet, pasi premtan të gjitha llojet e nëndarjeve pozitive për shoqërinë vendase (Hughes 1987).

Figura 2.12: Modeli i zhvillimit të qëndrueshëm në porte me perspektivë turistike

Burimi :Lucovic (2012)



Proçesi i prodhimit kulturor vë në punë shërbime të ndryshme – sidomos në fushën e shërbimeve vetiake, informative, teknologjisë së lartë, të gjitha këto kanë të bëjnë me “industritë krijuese” – që lidhen së tepërmi me ekonominë bashkëkohore urbane.

Nga ky këndvështrim, turizmi kulturor mund të shikohet si një *levë* e funksioneve të tjera urbane, të cilat vështirë se do të vazhdonin në mungesë të saj.

²⁴ Komisioni Botëror për Mjedisin dhe Zhvillimin 1987

2.4 Atributet e rëndësishme për një destinacion lundrimi

Në udhëtimin e tyre disa ditor deri në muaj, anijet turistike lëvizin në një itinerar të caktuar i cili përzgjidhet me shumë kujdes shumë kohë më parë se të realizohet ky udhëtim. Përzgjedhja e itinerarit, porteve tranzit apo ekskursioneve në territor realizohet duke u bazuar në një analizë të mirëfilltë nga menaxherët operacionalë dhe të marketingut të kompanive të anijeve turistike.

Cilat janë karakteristikat apo atributet që duhet të sigurojë një port për t'u përzgjedhur si pjesë përbërëse e itinerarit turistik?

2.4.1. Atributet e rëndësishme për një destinacion lundrimi

Boblin dhe Elbe (2007) mendojnë se një port për t'u shndërruar në një destinacion të suksesshëm atraktiv, duhet të ketë si element bazë infrastrukturën dhe shërbimet portuale. Hall (2006) përkrah këtë mendim duke nënvizuar faktin se që një port të jetë i suksesshëm, në mënyrë që të tërheqë pasagjerë, duhet të përmirësojë infrastrukturën.

Leipper (1990) në studimet e tij fokusohet në atraksionet por shkon edhe më tej, duke treguar tre aspekte për krijimin e një atraksioni: *itinerarin turistik*, *sinjalistikën* dhe *politikën*. Ndërsa Rodrigue dhe Nottebon (2013) hedhin tezën se sektori i lundrimit me anijet turistike fokusohet gjithmonë e më shumë në krijimin e itinerarëve të paharrushëm, mbresëlënës për pasagjerët dhe rrallëherë përqëndrohet në porte të vegjël.

Leipper (1995) mendon se bazë për përfshirjen e rajonit në destinacionet e anije turistike nuk mund të ishte thjesht madhësia e portit pritës, por *ekzistenca e atraksioneve dhe një rrjeti bashkëpunimi me ofruesit e shërbimeve turistike*.

Atraksionet tregëtare përbëjnë një kategori tjetër përfaqësimi në porte. Konsumi i atraksioneve tregëtare krijon të ardhura për qytetin, ndërsa konsumi i atraksioneve jotregëtare, siç janë parqet, mund të krijojë problematika të ndryshme, sidomos kur janë pranë qendrave të banuara (Rodrigue dhe Notteboom 2013).

Shumë destinacione mesdhetare, janë shembuj të rritjes dhe dështimit si një destinacion, argumenton Muller (2011) duke u bazuar në teorinë e ciklit të jetës së destinacioneve, shpjeguar nga Butler (1980). Ekziston një fazë në këto destinacione ku turizmi i anijeve turistike mund të luajë një rol të rëndësishëm në rritjen e numrit të vizitorëve (psh. Majorka, e cila më parë ishte thjesht një parajsë për charterat, ndërsa sot është një nga portet e linjave të anijeve turistike më të frekuentuar në Mesdhe).

Shumica e kërkimeve për të studiuar kërkesën për një destinacion, bazohen në faktin se udhëtarët drejtohen në një destinacion të vetëm (Lue, Crompton & Fesenmaier, 1993). Rrjedhmisht janë me të pakta në numër studimet për turizmin që zhvillohet në shumë destinacione, apo të cilat përqëndrohen në planifikimin e itinerarit.

2.4.2 Filiera portuale dhe krijimi i sistemit

Në sistemin portual, operatorët e anijeve turistike dhe autoritetet portuale kanë zhvilluar një sërë marrëveshesh të nevojshme për drejtimin e portit, ku autoriteti portual luan rolin e katalizatorit në bazë të nevojave dhe interesave të operatorëve ekonomik²⁵. Aktiviteti i anijeve turistike sot konsiderohet fitimprurës falë tarifave të larta për ankorimin e një anije brenda hapësirave portuale, bazuar në gjatësinë e anijes. Disa porte parashikojnë edhe tarifa në përpjestim me numrin e pasagjerëve të cilët përdorin terminalin për imbarkim të anijes.

Çmimi paraqet një kriter në zgjedhjen e porteve pasi kompanitë krahasojnë sistematikisht tarifat e ndryshme të praktikuara nga portet konkurruese, të cilat detyrojnë portet për një vlerësim më të mirë të konkurrencës.

Strategjia e porteve turistike, lidhet me opinionin që zhvillimi i një destinacioni duhet të shoqërohet pa dyshim me ekzistencën e infrastrukturës moderne dhe funksionale që lehtësojnë aksesin. Në shumë porte janë realizuar investime për ndërtime godinash për shërbime ndaj pasagjerëve, hapësira për lëvizjen tranzit të makinave dhe lidhjet e shpejta të portit me rrugët kryesore të komunikimit prezent në territor. Sistemi portual në funksion të anijeve turistike përdor modele organizative për menaxhimin e integruar të subjekteve duke siguruar një zhvillim të drejtë të funksioneve portuale.

2.4.3 Portet turistike dhe tipologjia e tyre

Funksionet që porti luan në sektorin e anijeve turistike janë të shumta të cilat dallojnë sipas funksionit të portit, *home port* ose *port of call*.

Home port (Port i nisjes apo përfundimit të udhëtimit)

Zakonisht bëjnë pjesë në këtë kategori, portet nga bëhet nisja e itinerarit apo përfundimi i itinerarit të një anije turistike. Zgjidhen zakonisht për këtë qëllim porte të cilat kanë akses drejt infrastrukturave territoriale (aerporte, linja metropolitane etj), të cilat lehtësojnë lëvizjen e pasagjerëve gjatë procesit të mbërritjes apo largimit. Një element i rëndësishëm është kapaciteti akomodues i qytet-portit, pasi mbështet nga ana logjistike akomodimin e pasagjerëve gjatë kohës së qëndrimit në qytet. *Home port* kanë nevojë për një sërë lidhjesh në problemet llogjistike:

- Lidhja e klientëve dhe lidhja e portit me rrjetet e brendshme;
- Organizimi i fluksit imbarkimi/ c'imbarkim dhe menaxhimi i bagazheve;
- Shërbime ndihmëse catering/ furnizimi me karburant.

Port of call: Quhet ndryshe port tranzit.

Zgjidhet me kujdes nga stafi operacional dhe i marketingut me qëllimin e krijimit të argëtimit apo mbushjes së kohës së udhëtimit të pasagjerëve gjatë qëndrimit për një kohë relativisht të shkurtër (zakonisht 8-12 orë) në territorin tranzit.

Funksionet: organizimi dhe kordinimi i një sistemi që përfshin gjithë aktorët të cilët bëjnë pjesë në filierën e anijeve turistike. Procesi tranzit dhe qëndrimi i anijeve, realizon një përfitim jo vetëm për autoritet portuale dhe shoqëritë e terminaleve, por edhe të ndërmarrjeve që kryejnë një sërë shërbimesh për anijen dhe pasagjerët si pilotimi, agensi incoming, agjensi detare, furnitori për anijet etj.

Faktorët jashtë hapësirave të portit janë një element tjetër të cilët kanë lidhje me territorin që e rrethon, pasi natyra turistike e lokaliteteve ndikon në kënaqësinë e vizitorit apo turistit.

2.4.4 Figura e Autoritetit Portual

Autoriteti Portual (AP) drejton dhe programon, drejtpërdrejtë apo duke deleguar në ndërmarrje të specializuara, aktivitete të ndryshme që zhvillohen në brendësi të portit, duke mbajtur fuqinë e kontrollit të drejtpërdrejtë për të garantuar respektimin e gjithë normave që rregullojnë përdorimin e zonave portuale.

Autoriteti portual siguron përfitim nga zhvillimi i aktiviteteve të anijeve turistike në porte, duke konsideruar një rendiment të lartë të sektorit në gjithë operacionet primare në të cilat, mbështetja është e nevojshme. AP janë ente publike të cilat varen nga Ministria e Transportit.²⁶ Në lidhje me kompanitë e anijeve turistike luajnë dhë rolin e promovuesit të territorit në të cilin organizojnë eskursione (marketing territorial) *duke inkurajuar itinerare me përfaqësues profesionistë, për ti garantuar turistit” një standart ekselent*, në sektorë të ndryshëm midis të cilëve dhe karakteristika si *cilësi, besim, siguri*.

Portet turistike mund të shndërrojnë ekperiencën e anije turistike në një ekperiencë më shumë dimensionale e cila përjetohet në një realitet të pranishëm në *Sistemin Lokal të Ofertës Turistike*.

Modelli i menaxhimit të anijeve turistike përfshin shërbime të ndryshme:

- *Shërbimi mbikqyrës*, emergjenca dhe mbrojtja civile, për të siguruar hyrjen dhe daljen e sigurtë gjatë manovrave, aktivizimin e stacioneve të ndihmës në brendësi të porteve;
- *Shërbimi i pilotazhit* dhe asistenca për ndërmarrjet me kontratë;
- *Shërbimet kulturore* të cilat gjenden në territor, ku futen aktorët e filierës që realizojnë ofertën turistike lokale.

2.4. Zinxhiri i vlerave të portit në një teori të bazuar në burimet potenciale

Zinxhiri i vlerave të portit në një *resourced based theory*, fokusohet pikërisht tek burimet të cilat ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit portual, të cilat e diferencojnë këtë port nga të tjerët. Në rastin e përfshirjes së porteve si *home port* apo *port of call*, këto diferencime dhe avantazhe konkurruese duhet të jenë akoma më të larta. Me anën e modelit Vrio (bazuar në formulimin e katër elementëve të biznesit (Vlerë, rrallësi, e paimitueshme, organizim) do jetë e mundur të përcaktohen nëse burime të tilla apo kapacitete të sistemit përbëjnë për realitetin portual një pikë të fortë apo pikë të dobët.


²⁶ VRIO-Value, Rareness, Imitability, Organization

- Alleanca mund të mendohet si një vlerë që zakonisht konsiderohet e tillë kur sistemi përballet me kërcënimet dhe oportunitetet e mjedisit.
- Rrallësia e ndërmarrjeve- varet nga numri i ndërmarrjeve portuale që operojnë në të njëjtin sektor dhe që kanë zhvilluar këtë tip alliance.
- Paimitushmëria- lidhet me mundësinë e dyfishimit apo zëvendësimit nga ana e autoriteteve të tjera portuale.

Në rastin e marrëveshjeve mund të përmendim psh., Costa Crociera që ka realizuar marrëveshje co-marketing me Entin e Komunës Napoli, Rajoni Lazio, apo Liguria secili prej tyre në drejtim të anijeve turistike apo kompani të tjera me qytetin e Barcelonës dhe Tarragonës. Midis portit dhe kompanive të anijeve turistike, janë zhvilluar sienergji, ku porti realizon promocionin e tij por edhe promocionin territorial. Në rastin kur punohet vetëm për modernizimin e terminaleve, do jetë një burim i imitueshëm, sepse dhe të tjerët, do mundohen të bëjnë të njëjten gjë me modernizimin e portit.

Figura 2.13: Zinxhiri i vlerave të një territori turistik portual

Burimi: Della Corte. V. Sevastano I.2008



2.5 Atraktiviteti turistik i qytet porteve të trashëgimisë

2.5.1. Atraktiviteti turistik

Përcaktuesit e vlerës së brendshme turistike janë komplekse dhe subjektive. Disa studime janë përpjekur të identifikojnë drejtuesit kryesor të atraktivitetit turistik dhe kanë dalë me tri kategori kryesore: faktorët klimatik / faktorët socialë kulturor, si dhe faktorët natyrorë.

Në kuadër të këtyre kategorive, veçanërisht disponueshmërisë së pamjeve historike, trashëgimisë natyrore, mundësitë/lehtësirat sportive sezonale (p.sh. shpatet e skive, lehtësirat sportive të ujit, etj), një klimë të këndshme, afërsia me bregdetin, dhe zhvillimin social/kulturor të një destinacioni janë gjetur të jenë të rëndësishme.

2.5.2 Atraktiviteti turistik i një rajoni portual

Përcaktuesi kryesor që drejton zhvillimin e turizmit të lundrimit (dhe si pasojë ndikimin e tij ekonomik) është *vlera e perceptuar turistike e një destinacioni ose e njohur ndryshe atraktive turistike*.

Një port detar i cili ndodhet në një rajon atraktiv për turistët nga përkufizimi tërheq më shumë turistë se portet në rajonet më pak tërheqëse.

Boblin dhe Elbe(2007) vlerësojnë *rëndësinë dhe rolin e infrastruktures portuale*, shërbimeve në një destinacion turistik, ndërsa Hall (2006) e lidh *suksesin e një porti me infrastrukturën* që ai vendos në shërbim të pasagjerëve.

Mundësia e krijimit të një rrjeti bashkëpunimi i cili lejon të përfshijë rajonin në një destinacion anijesh turistike, konsiderohet nga të gjithë këta studiues si element bazë për rritjen në të ardhmen.

Kjo rritje nënkupton shtimin e segmenteve të tregut, duke përfshirë, grupet rinore, familjet dhe segmentet e tjerë me nivel të ulët apo të lartë të ardhurash ekonomike. Megjithatë, për shkak të paragjykimëve, subjektivitetit, këta faktorë janë të vështirë për t'u matur.

Gjithashtu, *numri i shtretërve turistik për kilometër katror* të qytetit portual dhe rrethinave të saj mund të veprojë si një tregues për vlerën e brendshme turistike të një destinacioni. *Tabela e mëposhtme* përmbledh variablat të cilat përcaktojnë atraktivitetin turistik të një rajoni, së bashku me treguesit e tyre të sugjeruar respektiv sasi.

Tabela 2.6 :Variablat dhe treguesit e atraktivitetit turistik*Burimi: Tourist facilities in ports "The economic factor" European Commission (2010)*

Variablat	Treguesit
Vlera e perceptuar turistike	Dendësia e shtreterve turistik
Mirëdashësia turistike	Perceptimi i vet / sondazhi turistik

Një tjetër përcaktues i rëndësishëm i atraktivitetit të një porti për turistët është ‘dashamirësia turistike’ e tij ose shkalla në të cilën ai është ‘turistikisht-gati’. Në Civitavecchia, për shembull, fakti se vetëm shumë pak njerëz flasin anglisht dhe se nuk ka lehtësira turistike në dispozicion (të tilla si, një zyrë informacioni turistik, hartat dhe vendosja e shenjave në gjuhën angleze) në dhe rreth portit, largon turistët nga eksplorimi i mjedisit të këtij qyteti portual.

Sa për vlerën e perceptuar turistike ‘dashamirësia turistike’ është e vështirë të përcaktohet në formë sasiore. Për këtë qëllim portet përdorin perceptimin e tyre dhe/ose rezultatet e tyre nga sondazhet turistike për të gjykuar nivelin e tyre të dashamirësisë turistike.

Kur vlera e lartë e perceptuar është shumë e rëndësishme, dhe mirëdashësia turistike është relativisht e lehtë për të ndryshuar, një rajon i tillë ka potencial që të bëhet një rajon shumë tërheqës. Megjithatë, deri më tani, mungesa e mirëdashësisë turistike e pengon atë nga shfrytëzimi i këtij potenciali. Në të kundërt, një port i kufizuar është shumë miqësor-turistik, por nuk ka vlerë të madhe të brendshme turistike.

2.5.2.1 Qasja e një destinacioni turistik si destinacion lundrimi

Përcaktuesi i dytë i atraktivitetit të një rajoni si një destinacion lundrimi është qasja e tij. Ky funksion mund të ndahet në variabla, të tilla si lehtësia e qasjes së vetë portit (dhe lehtësia e qasjes së atraksionit(eve) turistike kryesor, të cilat mund të jenë vendosur në port dhe/ose rrethinat e tij. Në mënyrë të qartë, një port që është lehtësisht i arritshëm nga të dyja perspektivat do të ketë potencial me të madh ekonomik sesa një port që vetëm ofron qasje në një atraksion turistik, të gjithë faktorët e tjerë janë të barabartë. Qasja e një porti mund të matet me anë të distancave relative. Prandaj, qasja e një rajoni nga një perspektivë mund të vlerësohet duke marrë distancat relative në autostradën më të afërt, aeroportin më të afërt ndërkombëtar (në lidhje me “tregjet burimore”), dhe stacionin më të afërt hekurudhor si tregues.

Tabela 2.7: Variablat e aksesueshmërisë dhe treguesit e tyre përkatës*Burimi: Tourist facilities in ports The economic factor European Commission (2010)*

Variablat	Tregues(it)
Aksesi ndërlidhës	Distanca relative me autostradën më të afërt
	Distanca relative me aeroportin më të afërt ndërkombëtar
	Distanca relative me stacionin më të afërt hekurudhor
Aksesi tranzit	Distanca relative me tërheqjen(et) kryesore turistike

Nga ana e saj, qasja nga një perspektivë tranzit mund të matet duke përdorur distancën relative në atraksionin (et) turistik kryesor. Variablat e shkallës së aksesit së një destinacioni lundrimi së bashku me treguesit e tyre përkatës janë përmbledhur në *Tabelën 2.7*. Përveç nga distanca për shpërndarësit e transportit, kjo është një kërkesë që këto shpërndarës duhet të jenë të lidhur me tregjet burimore të turistëve të lundrimit.

2.5.2.2 Lehtësirat portuale

Përcaktuesi i fundit i atraktivitetit të një rajoni si një destinacion lundrimi janëqë lehtësirat portuale që kanë për të ofruar.

Lehtësirat portuale mund të ndahen në dy grupe kryesore.

- Grupi i parë përfshin ato *lehtësira* që janë tashmë të rëndësishme për pritjen e anijeve turistike tranzit (p.sh. thellësi të mjaftueshme, kapacitet të mjaftueshëm moli, etj)
- Grupi tjetër përmban *lehtësira të cilat janë vetëm të rëndësishme për ato porte* që kanë të bëjnë me *anijet turistike* (p.sh. prania e një terminali pasagjerësh, trajtim bagazhesh, etj).

Portet të cilat synojnë të shndërrohen në porte të mirëfillta turistike duhet të fillojnë duke shqyrtuar ekzistencën e lehtësive të grupit të parë dhe më vonë të vlerësojnë nëse hapësira portuale është e pajisur me lehtësira të tjera në funksion të shërbimit të turistëve.

Tabela 2.8: Lista preferenciale e lehtësirave portuale për ankorimin e anije turistike

Burimi: Tourist facilities in ports. The economic factor European Commission (2010)

Lehtësirat e përgjithshme / tranzit		Lehtësirat turistike	
Kapaciteti i mjaftueshëm ankorimi	1	Lehtësirat e trajtimit të valixheve	5
Lehtësira parkingu në lagje direkte / Shërbim trajnimi në lehtësirat e parkingut	2	Lehtësirat e sigurisë dhe doganës	6
Lehtësirat e deponimit të mbeturinave	3	Terminalet	7
Lehtësirat për furnizimin me karburant	4		

2.5.3 Konkurrueshmëria e destinacioneve të anijeve turistike

Nëse udhëtimi me anijet turistike, *mbërrin tek klientët në formën e një paketë, për realizimin, kontribuojnë në realitet një sërë aktorësh të cilët janë të lidhur nga marrëdhënie tregëtare* “biznes to biznes” “në mënyrë të tillë që të sjellin një rrjet që gjen zgjidhjen, me një produkt output të shitur klientit final” Cesare (2002).

Në pikëpamjen strategjike kjo sjell zhvillimin e një filiere portuale duke nënkuptuar edhe përfshirjen e aktorëve lokalë edhe nevojën e politikave të reja portuale. Portet kanë nevojë për një sërë instrumentash menaxhimi dhe bashkëpunimi me subjektet private. Aktivitetet portuale janë të rregulluara nga një sërë dispozitash ligjore që udhëheqin organizimin portual dhe gjithë shërbimet që kompletojnë ofertën e shërbimit portual, për çdo port qoftë për përdorim turistik-krijues, apo tregëtar industrial, ushtarak, kanë nevojë për një plan rregullues portual. Nga studimet e ndryshme në terren janë identifikuar “faktorët kyç të suksesit” për rajonet portuale turistike:

- Atraktiviteti turistik i një destinacioni / rajoni;
- Përshtatshmëria e një destinacioni / rajoni;
- Niveli i objekteve të portit.


Shkalla në të cilën një rajon i bën thirrje turistëve perceptohet të jetë përcaktuesi më i rëndësishëm i atraktivitetit të një rajoni si një destinacion udhëtimi. Me planifikimin e drejtë mundet të ndikohet perceptimi i një turisti drejt një destinacioni / rajoni, por kjo kërkon nga pikëpamja kohore një periudhë një afatgjatë dhe burime të konsiderueshme financiare.

Qasja e një rajoni është përcaktuesi i dytë për atraktivitetin. Ky faktor është i kushtueshëm për të ndryshuar, kërkon një plan afatmesëm deri afatgjatë. Përcaktuesi i tretë - *niveli i lehtësirave të portit* - është më i lehtë dhe më pak i kushtueshëm për të ndryshuar brenda një kohe relativisht të shkurtër.

Bazuar në nivelin e përshtatshmërisë dhe rëndësisë për çdo përcaktues, duke përdorur këto perspektiva, portet mund të kategorizohen në tetë kategori, bazuar dhe në pikat e dobëta dhe të forta (duke e konsideruar atë qoftë të lartë apo të ulët) të cilat janë përmbledhur në *Figurën 2.13*

Figura 2.14. Modeli për vlerësimin e pikave të forta të portit dhe kategoritë e portit

Burimi: Korporata e Politikave Kërkimore



a / Destinacion i dështuar

Një destinacion 'i dështuar' është një destinacion udhëtimi që ka pak ose asgjë për të ofruar. Një rajon i tillë ka një nivel të ulët të atraktivitetit turistik, është vështirë për të hyrë dhe ofron disa lehtësira portuale. Rrjedhimisht, ky lloj destinacioni nuk ofron vlera të mjaftueshme për të tërhequr turizmin e anijeve turistike.

b / Destinacion me potencial të ulët

Një destinacion me potencial të ulët udhëtimi ka të njëjtat të meta si një destinacion i dështuar, me përjashtim të faktit se ai ka lehtësira të përshtatshme portuale. Në mënyrë që të jetë në gjendje për të përmirësuar pozicionin e tij, ai duhet kryesisht të përqëndrohet në përmirësimin e aksesit të tij.

c / Destinacion porti klasik

Destinacioni porti klasik mund të përshkruhet si një destinacion që ka atraktivitet turistik të ulët, është lehtësisht i arritshëm dhe zotëron lehtësitë e mjaftueshme portuale për turizmin e lundrimit.

d / Destinacion me kthesë të pastër (port home)

Një destinacion me kthesë të pastër është një destinacion që kryesisht shërben si një port më njësi akomoduese për turistët e lundrimit. Si destinacion është relativisht i shëmtuar për turistët, ai zakonisht është lehtësisht i arritshëm pasi ai është në gjendje për të tërhequr turistë të lundrimit nga rajone të ndryshme (apo edhe vende) në bordin e portit të tij. Ai gjithashtu ofron një nivel të lartë të lehtësirave turistike.

d / Destinacion i pazhvilluar

Destinacionet e pazhvilluara kanë një tërheqje të konsiderueshme për turistët, por mungon aftësia për të shfrytëzuar këtë potencial në masë të plotë. Investimet në qasjen e rajonit dhe lehtësitat portuale janë të nevojshme në mënyrë që të përfitojnë atraktivitetin optimal të tij. Një shembull i një porti të tillë është Santorini, i cili është një ishull i vogël në arkipelagun grek dhe për këtë arsye ka qasje të kufizuara. Për më tepër, kur turistët e lundrimit dëshirojnë të vizitojnë ishullin, një teleferik me shina realizon tërheqjen e turistëve. Ndërsa ky lloj transporti vuan nga mungesa strukturore e kapaciteteve - veçanërisht gjatë sezonit të verës - Santorini është përmendur shpesh si një makth logjistik.

f / Destinacion i pastër tranzit

Si emri sugjeron, një destinacion i pastër tranzit i referohet një porti lundrimi që është përdorur vetëm për turizmin e lundrimit tranzit. Destinacioni në vetvete mund të jetë tërheqës dhe lehtësisht i arritshëm për turistët, por mungesa e lidhjeve me rrethinat e saj të drejtpërdrejta e bën portin të papërshtatshëm për aktivitetet kthesë. Një shembull tipik i një destinacion tranzit të pastër është Mykonos, i cili është shumë i preferuar për turistët dhe shumë e kuptueshme, për shkak se turistët mund të ecin në qytet direkt nga shtrati i anijes. Megjithatë, për shkak të mungesës së lidhjeve me rrethinat e tij të drejtpërdrejta (kryesisht për shkak të faktit se është një ishull), porti është i papërshtatshëm për aktivitete kthesë.

g / Destinacion me potencial të lartë

Një destinacion me potencial të lartë lundrimi ka aftësinë potenciale për t'u bërë një qendër e turizmit të lundrimit. Ai është i vendosur në një rajon që është tërheqës për turistët dhe ka një infrastrukturë të zhvilluar mire, që e bën atë shumë të arritshëm. I vetmi aspekt i renditur ulët

është niveli i lehtësirave të portit. Për të lehtësuar rritjen e mëtejshme, ai duhet të investojë në përmirësimin e lehtësirave të tij turistike në port dhe rrethinat e tij, sidomos lehtësirave për turistët si informacioni turistik, shenjat, etj.

h / Qendër e turizmit të lundrimit

Qendra e turizmit të lundrimit është shumë tërheqëse për turistët, lehtësisht e arritshme dhe ka lehtësira me cilësi të lartë portuale. Megjithatë, në mënyrë për të mbështetur pozicionin e saj konkurrues, fokusi është përmirësimi i renditjes së saj në të gjithë tre përcaktuesit, në mënyrë që të vazhdojë maksimizimin e potencialit të saj.

Një shembull kryesor i kësaj kategorie porti është Barcelona, e cila ka portin e lundrimit më të madh në Evropë për sa i përket pasagjerëve. Kjo është për shkak se Barcelona është një destinacion jashtëzakonisht popullor turistik dhe ka një port të vendosur direkt në afërsi të qendrës së qytetit.

Turistët në të vërtetë mund të ecin në qytet. Një udhëtim në qytet (me autobus apo taksì) merr vetëm disa minuta. Për të shmangur mbingarkesën në territor vëmendje e veçantë kushtohet investimeve afatgjata, p.sh., energjisë elektrike anës bregut ose lehtësirave moderne për depozitimin e mbeturinave.

Bazuar në karakteristikat e mësipërme të porteve në funksion të anijeve turistike, vendimarrja për zgjedhjen e porteve kalon nëpër fazat ku merren në shqyrtim alternative të ndryshme duke marrë në konsideratë bashkëpunimin me agjentët dhe shoqatat e porteve njëkohësisht.

2.6 Atraktiviteti turistik i qytet porteve të trashëgmisë

2.6.1 Gjashtë A-të e destinacionit

Konkurrueshmëria e porteve në lidhje me hapjen e tyre në drejtim të anijeve turistike ka filluar të merret në konsideratë vetëm vitet e fundit nga studiues të ndryshëm ndër të cilët mund të përmendim Papathanassis (2012); Gipson dhe Papathanassis (2010)²⁷ etj.

Në modelet e mëparshme, në konkurrueshmërinë e destinacionit nuk janë marrë në konsideratë elementë të cilat ndikojnë në një turizëm cilësor në turizmin e anijeve turistike dhe jo vetëm.


Në figurën e mëposhtme, paraqitet një model i krijuar nga Papathanassis (2012) bazuar në veprimin e klasterave të turizmit, por tashmë duke përfshirë elementët të grupuar në 6 A-të e destinacionit. Ajo e cila bie në sy është se jo vetëm atraksionet, aksesit, marketingu, shërbimet ndihmëse, aktivitetet janë pjesë e rëndësishme por një vënd të konsiderueshëm zënë mes tyre dhe autoritetet lokale, bizneset turistike, organizatat e menaxhimit të dhe universitetet²⁸.

Pregatitja e brezit të ri, format e reja të edukimit *learning by doing*, apo përfshirja në kërkimin shkencor e stafeve akademike vlerësohen nga autorët si element suksesi në të ardhmen.

²⁷ **CTUR** Cruise Traffic and Urban Regeneration of city port heritage URBACT Thematic Network

Figura 2.15: Gjashtë elementët ndihmës së atraksionit të destinacionit

Burimi : Papathanassis 2012



2.6.2 Strategjia e zhvillimit të Matricës së portofolit

Destinacionet portuale të cilat janë pritëse të turizmit të anijeve turistike, gjatë jetës së tyre kanë të përcaktuar dhe ciklin e jetës së produktit i cili kushtëzon sipas elementëve që përmban dhe modelin e strategjisë e cila do të implementohet në të ardhmen në zhvillimin turistik të destinacionit.


Ky model, i bazuar në 6A –të e Zhvillimit turistik dhe Zhvillimit të infrastrukturës sjell si rezultat krijimin e matricës e cila përcakton dhe stadin e zhvillimit turistik të destinacionit sipas ndarjes së mëposhtme:

- një *destinacion autentik* i turizmit të anijeve turistike;
- një *destinacion eskuziv*,
- një *destinacion tranzit*,
- apo *destinacion në vlerën maksimale të përdorimit të tij*.

Në figurën 2.19 jepen në mënyrë skematike këto kategori destinacionesh duke përcaktuar për to dhe elementët kryesorë ku fokusohet model i zhvillimit të matricës së destinacionit të anijeve turistike për secilën kategori.

Figura 2.19: Pozicionimi i destinacioneve dhe Zhvillimi i Matricës te portofolit

Burimi: Papathanassis, Breitner dhe DeGroot, (2014).



2.6.3. Itinerari turistik

Kur një itinerar përcaktohet, një sërë faktorësh merren në konsideratë. Homeport, pa dyshim, luan rolin kryesor në itinerar. Gjithashtu dhe kohëzgjatja është një faktor i cili influencon: sa më i gjatë udhëtimi, aq më shumë porte mund të vizitohen (Lingard, 2002).

Në 1991, Marti ka kryer një hulumtim që shqyrtoi rëndësinë e lundrimit itinerarin kur zgjedh një dalje në det. Sipas tij, *Port of Call*, zgjidhen duke u bazuar në koston (Marti, 1991) dhe pasagjerët kishin një tendencë për të qëndruar më shumë kohë në "Portet tranzit" dhe në më pak porte, duke e vendosur portin në vend të dytë.

Lidhur me perceptimin e menaxherëve në zgjedhjen e portit pritës, itinerari renditet i tretë. Pasagjerët të cilët udhëtojnë më shpesh me anije turistike preferojnë itinerar më të qetë dhe me më shumë ditë në det (Lingard, 2002; Cartwright dhe Baird, 1999; Haller, 2005).

Vetë udhëtimet në shumë destinacione në të njëjtën kohë, janë të lidhura me razionalizimin ekonomik; ato janë perceptuar për të kursyer kohë dhe mjete monetare lidhur me këtë udhëtim (Lue, 1993). Kjo përvojë në lundrim krijon tek klientët besimin dhe perceptimin se, në qoftë se ata do të vizitonin këto vende "një nga një", kjo do t'u kushtonte më tepër si në kohë ashtu edhe në mjete monetare (Mancini, 1999).

Shumica e kërkimeve për të studiuar kërkesën për një destinacion, bazohen në faktin se udhëtarët drejtohen në një destinacion të vetëm (Lue, Crompton dhe Fesenmaier, 1993). Rrjedhimisht janë me të pakta në numër studimet për turizmin që zhvillohet në shumë destinacione, apo të cilat përqëndrohen në planifikimin e itinerarit. Butler (1996) vë në dukje se lloji i turistëve është po aq i rëndësishëm sa numri, duke pasur parasysh këtë se profili i vizitorit përcakton aktivitetet e ndërmarra, kohëzgjatjen e qëndrimit, dhe ndërveprimin me popullsinë lokale.

2.6.4 Bashkepunim stakeholder partnership

Një numër gjithnjë e më i madh autorësh (Ecans, 2002; Hall 199; Morais 2005; Aas, 2005, Hunter 1999) hedhin idenë e nevojshmërisë së dialogut dhe bashkëpunimit në partnership midis konservatorëve, zhvilluesve të turizmit dhe komunitetit lokal.

Bramwell dhe Lane (1999) përshkruan partnershipin si një *“veprim ndërsektorial midis pjesëve bazuar të paktën në zbatimin e disa normave që synojnë një çështje të përbashkët për një politikë dhe qëllime specifike”*. Hall (1999) nënvizon se partnership-i shpesh realizohet në një formë bashkëpunimi me një integrim vertikal dhe zhvillim të qëndrueshëm. Megjithatë shumë autorë, nënvizojnë si thelbësorë nevojën për të tërhequr komunitetin lokal në procesin e vendimmarrjes (Aas 2005, Jamal dhe Getz 1999).

Hunter (1999) thekson *“është ekstremisht e vështirë të imagjinohet formulimi dhe implementimi për çdo përjasje të turizmit të qëndrueshëm në mungesë të autoriteteve të planifikimit dhe zhvillimit të kontrollit lokal dhe pa përfshirjen e komuniteteve lokale në procesin e planifikimit”*.

Van den Borg (1995) nënvizon se komunat duhet të fokusohen në menaxhimin, monitorimin dhe kontrollin e fluksit turistik në qytete dhe një kujdes i rëndësishëm duhet të jepet eskursionistëve. Sipas Butter (1996) nënjë menaxhim të vizitorëve vështirësia më e madhe në zhvillimin e turizmit nuk është të tërheq turistët por të kontrolloj atë.

Formimi i *partneriteteve publike-private* në lidhje me projektet e zhvillimit përbën pjesën kryesore të kësaj qasjeje, siç ajo përfaqëson një mënyrë për të artikuluar qëndrime të ndryshme dhe interesa ndoshta konfliktuale rreth objektivave të përbashkëta. Në këtë mënyrë, përgjegjësitë janë të përbashkëta dhe mjetet financiare për investime të kushtueshme mund të ngrihen, duke ruajtur disa nivele të kontrollit dhe llogaridhënies publike në zhvillimin e tregut të shtyrë (Bramezza dhe Van Klink 1994). Secila palë e interesuar është një *“aktor”* në zhvillimin e turizmit të anijeve turistike, sepse me sjelljen e tij, ai ose ajo ndikon në rezultatin e procesit.

Është e rëndësishme, pastaj, për të njohur se secili aktor vendos në mënyrë strategjike; dhe se strategjitë nuk janë të kufizuara në vendimet e thjeshta por mëse komplekse.

2.7 Modeli Konceptual i Punimit

Modeli përfaqëson një sërë faktorësh të cilët luajnë një rol përcaktues në konkurrencën e destinacionit turistik. Modeli kërkon të vlerësojë cilët janë faktorët të cilët ndikojnë në përzgjedhjen e portit të Durrësit si një port tranzit në sektorin e udhëtimeve të anijeve turistike dhe bazohet në modelin e attributeve të destinacionit, duke marrë në konsideratë një sërë prej tyre duke konfirmuar në këtë mënyrë dhe atraksionin e destinacionit. Në modelin e integruar mjedisi mikrokonkurrenës dhe mjedisi makro-global janë përfshirës sipas situatës. Modelle të tjera të atraktivitetit të destinacionit janë marrë në konsideratë si De Keyser dhe Vanhove (1994), Hassan 2000, Heath 2000; të cilët zhvilluan modelin teorik të nënvizimit të faktorëve makroekonomik e që influencojnë industrinë e turizmit. Inskeep (1991) identifikon tërheqjet e turistëve dhe aktivitetet, akomodimin, objektet e tjera të udhëtimit dhe shërbimet, transportin, infrastrukturën, elemente institucionale si componentët bazë të zhvillimit të turizmit. Pearce (1981) njeh pesë elemente të ofertës së turizmit: atraktiviteti, transporti, akomodimi, shërbimet mbështetëse dhe infrastruktura. Murphy (1985) bën dallimin midis kërkesës dhe ofertës. Për më tepër respekti i shkon dhe *“Ritchie dhe Crouch (2000)”* ku modeli qartë njeh faktorin e kërkesës si një element themlbësor siç nënvizohet dhe nga Dwyer dhe Kim (2003).

KAPITULLI III

METODOLOGJIA E NDJEKUR DHE INSTRUMENTAT E PËRDORUR

Ky kapitull shpjegon metodologjinë e përdorur për realizimin e këtij studimi. Në mënyrë që të arrihen objektivat e vendosura, Bell dhe Hoppie (2002)²⁹ saktësojnë se duhet të ekzistojë një ide e qartë për t'u shtjelluar, dhe për këtë arsye është i rëndësishëm selektimi i teknikave të kërkimit të cilat do të përcaktojnë qëllimin dhe limitet e kohës së studimit.

Përcaktimi i metodave të sakta të kërkimit është vendimtar (Veal, 2006; Hakim 2000) dhe për këtë arsye, metodologjia është një kornizë që tregon se si duhet të organizohet puna e një studimi, bazuar në literatura, principe apo supozime të ngjashme. Kjo analizë përshkruan dhe nxjerr në pah elementët për kryerjen e hulumtimit. Ajo hedh dritë mbi pyetjet kryesore dhe ato ndihmëse. Ajo adreson sugjerimet për problemet që hasen në fushën e studimit.

Bazuar në objektivat e parashtruara në kapitullin e parë, shtrimi hipotezave ngre siparin e kërkimit duke përshkruar njëkohësisht dhe metodën e zgjedhur për hulumtim, arsyet e zgjedhjeve të pyetjeve dhe procedurës së anketimit. Pas prezantimit të mënyrës së hartimit të pyetësorit analizohet vlefshmëria dhe besueshmëria e tij.

Studimi përmban përdorimin e metodave sasiore dhe cilësore për realizimin e tij. Kombinimi i formave sasiore dhe cilësore, po përdoret gjithnjë e më tepër në shkencat sociale, për shpjegimin e fenomeneve të ndryshme (Rovai, Baker dhe Ponton 2014). Shumë metoda të ndryshme përshkruajnë se në shyrtimin e literaturës ekzistojnë rregulla strikte dhe teknika fikse, por Clough dhe Notbrown (2002) shpjegojnë se në praktikë shumë studiues nuk kanë eksperiencë në përdorimin e këtyre metodave dhe e përdorin atë pa kujdes.

Studimit sasior i paraprin një analizë e gjatë studimore dhe vëzhguese në sektorin e turizmit detar, portual, trashëgimisë kulturore dhe shumë faktorëve të rëndësishëm në studim. Kapitulli fillon me trajtimin hipotezave të këtij punimi, për të vazhduar më pas me metodën e zgjedhur të studimit, arsyet e zgjedhjes të pyetësorit si metodë për mbledhjen e të dhënave primare, përcaktimin e kampionit të studimit dhe procedurën e mbledhjes së të dhënave.

Më tej vijohet me paraqitjen e mënyrës së hartimit të pyetësorit, përpunimin e tij, duke përfunduar me vlefshmërinë dhe besueshmërinë e pyetësorit. Gjatë realizimit të këtij studimi përdoren të dhëna sekondare dhe më pas ato primare të cilat diskutohen në seksionet në vijim.

Të dhënat dytësore dhe rishikimi i literaturës

Rishikimi i literaturës zakonisht ndryshon midis të dhënave dytësore dhe parësore, sepse te dyja paraqesin forma të dallueshme të informimit dhe provave të kërkit. Të dhënat dytësore kryesisht nxirren nga burimet e dokumentuara. Ato analizojnë shpesh kontekstin e rishikimit të literaturës "metoda më e përdorur për kërkimet sociale" (Mason 1996).

Të dhënat dytësore përfshijnë një rishikim të punimeve të mëparshme të cilat formojnë një hap të nevojshëm për kërkimet, sidomos kur bazohemi në përpilimin e pyetjeve të kërkit.

Veal (2006)³⁰ thekson rëndësinë e përdorimit të të dhënave, bazuar në përdorimin e tyre të mëparshëm deri në krijimin e rastit të krahasimeve. Ai mendon se të dhënat dytësore të cilat përdoren si të dhëna parësore në një projekt tjetër mund të përdoren në një punim të dytë si të dhëna dytësore. Bell (2005) shton se kërkuesi shkencor duhet të tregojë në studimet e veta literaturën e duhur e cila përmbledh dhe prezanton konceptin e punimit që do të realizohet.

Të dhënat parësore

Kërkimet parësore përfshijnë mbledhjen e të dhënave të drejtëpërdrejta, origjinale të cilat mund të jenë strukturuar sipas një metodologjie të caktuar (Clark 1998, Jennings 2001; Veal 2006). Sipas Preece (1994), pika kryesore e të dhënave parësore është karakteri empirik dhe përfshirja personale e kërkuesit shkencor gjatë eksperiencës dhe observimi i situatave aktuale dhe reale. Kërkimi parësor mund të shoqërohet me shpenzime dhe konsumim kohe Veal (2006) dhe zakonisht përfshijnë si metoda cilësore dhe sasiore të cilat do merren në shqyrtim në vijim. Denscombe (2010) nënvizon se mbledhja e të dhënave parësore realizohet në bazë qëllimeve dhe objektivave të kërkit.

Mbledhja e të dhënave primare për këtë punim është përqëndruar në disa metoda të mbledhjes së të dhënave: intervista, observime, pyetësore duke integruar metodat cilësore me metodat sasiore.

Qëllimi i këtij punimi është të studioj nëse qyteti porti i Durrësit është atraktiv në kuadër të turizmit të anijeve turistike dhe si menaxhohet territori i tij, duke synuar krijimin e një modeli për menaxhimin dhe marketingun e territorit të Durrësit në funksion të këtij aktiviteti turistik me shumë mundësi zhvillimi në të ardhmen.

Metodologjia e përdorur ka qënë në funksion të realizimit të këtij qëllimi.

Pjesëmarrja në disa aktivitete trajnimi gjatë realizimit të Projektit Tempus CHTMBAL, ku Universiteti A. Moisiu Durrës ishte partner, ka krijuar mundësinë e rishikimit të literaturës pranë Qendrës së Observatorit të Turizmit në Villaseka, pjesë e Universitetit Rogira i Vigili, në Tarragona, Spanjë. Gjatë kësaj periudhe janë konsultuar gjerësisht dhe bibliotekat elektronike ndërkombëtare për sa i përket tematikës së punimit.

Nga analiza e një literature të gjërë akademike por edhe teknike, u identifikuan komponentët kryesorë të përcaktimit të kriterëve për përzgjedhjen e portit e qëndrimit tranzit, e cila përcakton dhe shkallën e atraktivitetit të qytet- portit të Durrësit përkundrejt porteve të tjera në zonën e Adrion-it.

Pas shqyrtimit të literaturës për konceptet të cilat i përkasin fushave të ndryshme, specifika e rastit të punimit, kërkoi ndërthurjen e metodave cilësore dhe sasore. Terminologjia e përdorur kërkoi specifikime të elementeve të tilla si: destinacioni turistik, konkurrueshmëria e porteve, trashëgimia, autoriteti portual, atributet për zhvillimin e turizmit të anijeve turistike. Praktikat më të mira në Adriën: Portet e Venecias, Pireut dhe i Dubrovikut (strategjitë e përdorura për shndërrimin e tyre në pika të rëndësishme të sektorit të anijeve turistike në zonën e Adriës dhe të Mesdheut).

Instrumenti matës primar i kërkimit është pyetësi drejtuar menaxherëve operacionalë dhe të marketingut të kompanive të anijeve turistike, të cilët janë përgjegjës për përcaktimin e itinerarit të radhës. Besueshmëria dhe vlefshmëria e tij ka qenë kriteri kryesor gjatë fazës së hartimit.

Metodologjia vazhdon me përpunimin e rezultateve dhe opinionëve duke synuar të sjelli një model për mundësinë e menaxhimit dhe marketingut të portit të Durrësit në të ardhmen, bazuar në:

- Mundësinë e krijimit të kushteve në aspektin portual për pritjen e anijeve turistike;
- Mundësinë e rijetëzimit të Durrësit turistik (gërmimet arkeologjike në zonën e Amfiteatrit të Durrësit);
- Rishikim i planit të vendosjes së anijeve turistike, përdorimit përfundimtar të kalatës 5 si dhe bashkëpunimi Privat Publik.


3.1 Hipotezat e Punimit

Një hipotezë kërkimore është një shpjegim i propozuar për një dukuri të vërtetueshme, ose një hamendësim i bërë në mënyrë që të gjenden dhe të provohen pasojat e saj logjike dhe empirike (Descombe, 2010).

Korniza konceptuale, bazuar në pyetjet kërkimore, sugjeron një listë të gjatë të hipotezave në lidhje me atraktivitetin dhe përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e portit nga kompanitë e anijeve turistike. Pikërisht mbi këto hipoteza është orientuar dhe puna kërkimore në drejtim të vërtetimit apo testimit të tyre, për t'i dhënë përgjigje pyetjes përfundimtare çështjes kryesore kërkimore.

Të katërt hipotezat e mëposhtme u përpiluan në mënyrë të tillë që të bëheshin e mundur marrja e mendimit si për zonën e Adriës ashtu dhe për zonën e Durrësit.

- **Hipoteza 1:** Pozicioni gjeografik është i rëndësishëm në vendimmarrjen për përcaktimin e porteve të itinerarit të sektorit të kruizerave;
- **Hipoteza 2:** Infrastruktura dhe kuadri ligjor është e rëndësishme në vendimarrje;
- **Hipoteza 3:** Marketingu dhe sjellja konsumatore janë të rëndësishëm në vendimarrje;
- **Hipoteza 4:** Kostot dhe përfitimet janë të rëndësishme për vendimmarrjen;



Në mënyrë më të hollësishme së bashku me nënhipotezat gjithçka paraqitet në dy tabelat e mëposhtme specifiku, hipotezat për zonën e Adrionit dhe hipotezat për portin e Durrësit.

Tabela 3.1: Hipotezat kërkimore që do të testohen në Adrion

H 1	Pozicioni gjeografik është i rëndësishëm në vendimmarrjen për përcaktimin e porteve të itinerarit të sektorit të anijeve turistike në Adrion	H1.1: Zona Adrion është një zonë e pasur me trashëgimi natyrore e kulturore;
		H1.2: Afërsia e porteve dhe kryeqyteteve në zonën Adrion është e lartë
		H1.3: Niveli i aksesit ajror, detar, rrugor në zonën Adrion është i lartë
		H1.4: Zona Adrion kombinon shumë vende turistike
		H1.5: Zona Adrion ofron mundësinë e përmirësimit të itinerarit të anijeve turistike
		H1.6: Zona Adrion ka një klimë dhe sezonalitet optimal
H 2	Infrastruktura dhe kuadri ligjor është e rëndësishme në vendimarrje në Adrion.	H2.1: Zona Adrion ofron lehtësira dhe shërbime të mëdha të portit
		H 2.2: Portet në Zonën Adrion nuk janë të mbi populluara
		H 2.3: Portet në Zonën Adrion kanë cilësi të lartë standartesh.
		H 2.4: Portet në Zonën Adrion nuk kanë probleme me çështje ligjore
		H 2.5: Portet në Zonën Adrion ofrojnë një akses të madh detar.
		H2.6: Portet në Zonën Adrion ofrojnë shumëllojshmëri dhe cilësi të opsioneve të ekskursioneve në breg
		H2.7: Nuk ka probleme me rregullat e vizës në Zonën Adrion
		H 2.8: Zona e Adrion është një destinacion i parrezikshëm / i sigurt.
H 3	Marketingu dhe sjellja konsumatore janë të rëndësishme në vendimarrje në zonën Adrion.	H3.1: Zona e Adrion ka kërkesë të konsumatorëve / reagime të pasagjerëve.
		H 3.2: Kompania turistike zotëron të dhëna historike në lidhje me Zonën Adrion
		H3.3: Ka hulumtime të tregut të brendshëm në lidhje me Zonën Adrion.
		H3.4: Prognozat e të ardhmes për Zonën Adrion janë të mëdha.
		H3.5: Marketingu turistik është i lartë për Zonën Adrion
		H3.6: Ka një disponueshmërinë të lartë të informacionit për destinacionet në Zonën eAdrion
		H3.7: Ka një disponueshmëri të lartë të guidave (gjuhëve) për Zonën eAdrion.
H 4	Kostot dhe përfitimet janë të rëndësishme për vendimarrjen në zonën Adrion.	H 4.1: Zona Adrion ofron alternativa të mëdha të kostos/përshtatjes ekonomike;
		H4.2: Zona Adrion ofron një mundësi të madhe fitimi
		H 4.3: Zona Adrion ka një nivel të mirë të çmimeve brenda destinacionit.
		H 4.4: Zona Adrion ka mundësi të mira tregtare.

Tabela 3.2: Hipotezat kërkimore që do të testohen për portin e Durrësit

H 1	Pozicioni gjeografik është i rëndësishëm në vendimmarrjen për përcaktimin e portit të Durrësit pjesë e itinerarit të anijeve turistike.	H1.1: Durrësi është i pasur me trashëgimi natyore e kulturore;
		H1.2: Afërsia e Durrësit me kryeqytetin dhe zonat atraktive është e lartë
		H1.3: Niveli i aksesit ajror,detar, rrugor në portin e Durrësit është i lartë
		H1.4: Durrësi kombinon shumë vende turistike
		H1.5: Durrësi ofron mundësinë e përmirësimit të itinerarit të anijeve turistike
		H1.6: Durrësi ka një klimë dhe sezonalitet optimal
H 2	Infrastruktura dhe kuadri ligjor është i rëndësishëm në vendimarrje në lidhje me portin e Durrësit.	H2.1: Porti i Durrësit ofron lehtësira dhe shërbime të mëdha
		H 2.2: Porti i Durrësit nuk është i mbipopulluar
		H 2.3: Porti i Durrësit ka cilësi të lartë standartesh.
		H 2.4: Porti i Durrësit nuk ka probleme me çështje ligjore
		H 2.5: Porti i Durrësit ofron një akses të madh detar.
		H2.6: Porti i Durrësit ofron shumëllojshmëri dhe cilësi të opsioneve të ekskursioneve në breg
		H2.7: Nuk ka probleme me rregullat e vizës në portin e Durrësit
		H 2.8: Durrësi është një destinacion i parrezikshëm / i sigurt.
H 3	Marketingu dhe sjellja konsumatore janë të rëndësishëm në vendimarrje nëlidhje me qytetin e Durrësit.	H3.1: Durrësi ka kërkesë të konsumatorëve / reagime të pasagjerëve.
		H 3.2: Kompania anijeve turistike zotëron të dhëna historike në lidhje me portin e Durrësit.
		H3.3: Ka hulumtime të tregut të brendshëm në lidhje me portin e Durrësit.
		H3.4: Prognozat e të ardhmes për portin e Durrësit janë të mëdha.
		H3.5: Marketingu turistik është i lartë për Durrësin.
		H3.6: Ka një disponueshmërinë të lartë të informacionit për portin e Durrësit
		H3.7: Ka një disponueshmëri të lartë të guidave (gjuhëve) për Durrësin
H 4	Kostot dhe përfitimet janë të rëndësishme për vendimarrjen në lidhje me Durrësin.	H 4.1: Porti i Durrësit ofron alternativa të mëdha të koston/përshtatjes ekonomike;
		H4.2: Porti i Durrësit ofron një mundësi të madhe fitimi
		H 4.3: Durrësi ka një nivel të mirë të çmimeve brenda destinacionit.
		H 4.4: Durrësi ka mundësi të mira tregtare.

3.2 Hartimi i pyetësorit

Instrumenti kryesor i përdorur gjatë këtij hulumtimi bazohet në instrumentin klasik të anketimit për vlerësimin e atraktivitetit me qëllim përcaktimin e variablave sipas kontekstit.

Informacioni i siguruar nga pyetësorët ndryshon nga të dhënat e siguruar nëpërmjet intervistave, observimeve apo dokumenteve sepse pyetësorët prodhojnë informacion të shkruar i cili është mbështetur drejtëpërdrejtë nga kampioni i njerëzve të përzgjedhur në përgjigje të pyetjeve të realizuara nga kërkuesi shkencor Descombe (2010). Veal (2006) nënvizon faktin se kërkuesi duhet të jetë shumë i saktë rreth të dhënave që duhet të kërkojë që në momentin e parë, në ndryshim me metodat dhe teknikat e tjera, siguron të dhëna të pakthyeshme. Vlefshmëria e përgjigjeve merret në konsideratë nëse kërkuesi ka realizuar një kërkim skrupoz dhe me përgjigje të ndershme. Pyetësorët zakonisht përfshijnë një numër subjektesh dhe paraqitjen e gjetjeve në terma numerike Veal (2006).

Pyetësorët lejojnë mbledhjen e informacionit me një frekuencë të tillë duke përfshirë perceptimin e një popullsie të caktuar. Gjithsesi, zakonisht pyetësorët ndjekin procedurat e kërkimit të cilat lehtësojnë verifikimin dhe përdorimin e metodave për interpretimin e të dhënave.

Për qëllime të këtij studimi, janë realizuar dy tipe pyetësorësh. Metodologjia e përdorur është bazuar në ndërthurjen e instrumentave kërkimore sasiorë dhe cilësorë të cilat janë përfshirë në këtë hulumtim të vlerësimit të atraktivitetit turistik portual (pyetësori i parë), por dhe përshtypjet e vizitorëve për menaxhimin e qytetit të Durrësit (pyetësori i dytë). Gjatë punimit është zgjedhur të thellohet përcaktimi i konkurrueshmërisë në realitetet portuale në bazë të skemës teorike të Resourced Based Theory. Kjo zgjedhje nuk është rastësore por sepse merr në shqyrtim avantazhet konkurruese të burimeve duke nënkuptuar një efikasitet më të lartë se konkurrentët.

U përdorën dy tipologji pyetësorësh:

Pyetësori 1: Opioni i Stakeholder të huaj

Pyetësori me të cilën u vlerësua opinioni i menaxherëve të sektorit të organizimit të kruizerave (stakeholder të huaj, në fushën e marketingut, itinerareve dhe menaxhimit operacional), të cilët vlerësuan kriteret që përcaktojnë përzgjedhjen e portit, si një port pritës për anijet turistike. Vlerësimi u krye në pyetësor në dy hapësira gjeografike të mundshme. Duke u nisur nga kriteret e zgjedhjes në shkallë botërore, studimi u fokusua rreth zonës së Adriatikut dhe të portit të Durrësit.

Figura 3.1 : Modeli i realizimit të pyetësoreve



Seksioni i parë: Përmban pyetje të përgjithshme rreth kompanive të cilat planifikojnë intinerarin e lundrimit, mbi atraktivitetin e Adrionit, mbi madhësinë e kompanive.

Seksioni i dytë: Ndahet në 4 dimensione zona ku secila prej tyre ka një sërë variablash:

- Pozicioni gjeografik trashëgimia kulturore
- Infrastruktura dhe kuadri ligjor
- Kosto përfitimet
- Marketingu portual dhe territorial

Pyetësi u ndërtua në **Qualtrics**. Përmban 87 pohime të vendrosur në tre nëngrupe në një shkallë 5 pikëshe të shkallës Likert. Secili nëngrup, kishte pyetje të cilat i drejtoheshin pjesëmarrësve në lidhje me tre zona të ndryshme gjeografike. Pyetësi fillimisht u shpërnda on line, por vetëm 10 prej tyre u kthyen të plotësuar. Pyetësi fillimisht u shpërnda on line, por vetëm 10 prej tyre u kthyen të plotësuar. Pjesa tjetër (22) u plotësua drejtëpërdrejtë nga menaxherët³¹.

Indeksi i Atraktivitetit

Gjatë procesit të vlerësimit nga ana statistikore u përdor dhe Modellimi i ekuacioneve strukturore SEM i cili bazohet në vlerësimin e marrëdhënieve të drejtëpërdrejta apo të tërthorta midis faktorëve të dukshëm apo të padukshëm të cilat sollën një variabël të matshëm: Indeksin e atraktivitetit.

Figura 3.2: Indeksi i atraktivitetit SEM



³¹ Pyetësi u plotësua drejtëpërdrejtë gjatë eventit: “Pan-European dialogue between cruise operators, ports and coastal tourism stakeholders” realizuar në datat 5-6 Mars 2015, Bruksel, Belgjikë.

Pyetësi 2. Profili i vizitorit të anijeve turistike

Gjatë periudhës Tetor 2013-Dhjetor 2014 u plotësuan 327 pyetësore nga udhëtarët e anijeve turistike, të cilët zgjidhnin të vizitonin Durrësin dhe Krujën gjatë kohës së qëndrimit në portin e Durrësit. Në përfundim u krijua një profil i vizitorit të anijeve turistike në Durrës, duke përdorur për këtë qëllim, pyetje të profilit, social, ekonomik, demografik, kulturor etj. Në vlerësimin e përgjigjeve vetëm 290 prej pyetësorëve u konsideruan të vlefshëm për realizimin e punimit.

3.3 Përcaktimi i kampionit

Gjatë studimit u përdor një nga modelet më të zakonshme të kampionimit jo probabilitar i quajtur kampionim me kuota. Kampionimi me kuota përfshin njohjen e disa karakteristikave të popullatës për t'u pyetur në secilën kategori dhe më pas personat të cilët duhen intervistuar, i lihen në dorë intervistuesit.

Kemperi dhe Teddie-ja (2000) ofrojnë udhëzimet e tyre për përzgjedhjen e kamponit.

- *Së pari*, teknika e kampionimit buron logjikisht nga kuadri konceptual i pyetjeve të kërkimit.
- *Së dyti*, kampioni duhet të gjenerojë të dhëna të besueshme për çështje që po studiohet.
- *Së treti*, kampioni duhet të krijojë mundësinë e bërjes së përgjithësimeve të qarta ose të besueshme nga të dhënat.

Kruskal dhe Mosteller (1979)³² mendojnë se për të zgjedhur kampionin duhet të merren parasysh disa aspekte si:

- Pjesa e popullsisë
- Mbulimi i popullsisë
- Kampione përfaqësuese të mjaftueshme për një qëllim të vecantë
- Kampione përfaqësuese të cilat lejojnë një vlerësim të mirë

Onwegbuzie dhe Collins (2007) argumentojnë se pothuajse të gjithë kërkuesit pavarësisht të metodës të cilën përdorin, bëjnë përgjithësime kur interpretojnë të dhëna. Mënyra e anketimit gjithashtu është e rëndësishme. Me zhvillimin e teknologjisë një pjesë e rëndësishme e anketimeve kohët e fundit realizohet on-line. Zakonisht koha e mbledhjes së të dhënave të vrojtimit në internet zakonisht varion nga 10-20 ditë dhe në disa raste mund të jete më e shkurtër (Blair., Czaja., Ronald (2014). Jo gjithmonë konsiderohen si forma të pranueshme. Cobanoglu, Warde and Moreo (2001) arritën të sigurojnë vetëm 44 % të pyetësoreve të plotësuar nga internet. ³³ Pyetjet dhe fjalitë në këtë lloj pyetësorësh duhet të jenë të shkurtra dhe jo më shumë se 4-5 kategori përgjigjesh të mundshme (Payne, 1951)³⁴

3.4 Çështjet etike

Studiuesja ka zbatuar të gjitha standartet etike për të siguruar se kërkimi nuk dëmtonte pjesëmarrësit. Në mënyrë që të mbroheshin të drejtat e pjesëmarrësve u është prezantuar atyre paraprakisht informacion në pjesën e sipërme të formularit. Pjesëmarrësve u është marrë miratimi për pjesëmarrje në studim dhe nuk u është kërkuar asnjë e dhënë identifikuese.

3.5 Variablat e konsideruara në punim

Në kapitullin e parë ku është prezantuar dhe objektivi i kërkimit janë parashtruar pyetjet kërkimore të cilat risillen edhe një herë si më poshtë vijon:

- A mund të konsiderohet porti i Durrësit si një port me perspektive në itineraret e anijeve turistike në të ardhmen?
- Cilët janë faktorët të cilët ndikojnë në përzgjedhjen e “ *port of call të itinerarit*” dhe atraktivitetit të një porti?
- A është i lidhur atraktiviteti i portit të Durrësit me infrastrukturën portuale dhe territoriale?
- A është i lidhur atraktiviteti i portit të Durrësit me përfitimet ekonomike të kompanive që realizojnë itineraret turistike?
- A është i lidhur atraktiviteti i portit të Durrësit me marketingun portual dhe të destinacionit?
- A mundet që një ent i cili kujdeset për Menaxhimin e Destinacionit të jetë një element baze për të ndikuar në rritjen e vizibilitetit të portit të Durrësit në të ardhmen?

Bazuar në këto pyetje dhe në literaturën e marë në shqyrtim janë përzgjedhur variablat të cilët përfaqësojnë dhe dimensionet kryesore ku bazohet turizmi i udhëtimeve me anije turistike.

Variablat e pavarur janë:

- **Dimensioni 1:** Pozicioni gjeografik dhe trashëgimia kulturore
- **Dimensioni 2:** Infrastruktura dhe kuadri ligjor
- **Dimensioni 4:** Ndikimi ekonomik i turizmit të anijeve turistike
- **Dimensioni 5:** Roli i marketingut portual dhe territorial

Variabli i varur: **Atraktiviteti i destinacionit**

3.6 Metoda sasiore dhe cilësore

Dy karakteristika unike të botës shkencore janë objektiviteti dhe përdorimi i të dhënave empirike (Gilli dhe Jackson, 2002). Në kontrast me kërkime sasiore e cila kërkon për të shpjeguar fenomene apo proçese të caktuara nga kontrollimit të variablave, hulumtimi cilësor përpiket për të kuptuar kompleksitetin e marrëdhënieve dhe perceptimet brenda një mjedisi duke shqyrtuar një sërë variablash (Stake, 1995; Holiday, 2002).

Qëllimi i këtij studimi është që të zhvillojë një kuptim të konteksteve politike, ekonomike, kulturore dhe sociale në të cilën menaxhimi mjedisor i portet zhvillohet një qasje cilësore u vlerësua si më e përshtatshme.

Studimet e mëhershme në anën portet kanë përdorur qasjen e studimit të rastit (Li, 1999) i cili ofron përparësi për përdorimin e kësaj metode në këtë vend të kërkimit. Hulumtimi cilësor është përdorur në këtë studim, duke realizuar intervista ballë për ballë me elementë të industrisë të anijeve turistike dhe menaxherët e portit, të cilët klasifikohen si elita të intervistuarish (Marshall dhe Rossman, 1995). Metodot cilësore përfshijnë dhe intervista me aktorë të sektorit të turizmit të cilët bashkëpunojnë me sektorin e udhëtimeve me anije turistike si më poshtë vijon:

- Intervistë me përfaqësues të Ministrisë të Turizmit
- Intervista me drejtues të Autoritetit Portual Durrës
- Intervista me përfaqësues së Kompanive koncesionare në portin e Durrësit
- Intervista me aktorë të turizmit (agjensi turistike, tour operator, guida turistike)
- Intervista me përfaqësues të Drejtorisë Rajonale Të Kulturës Kombëtare Durrës
- Interviste me ekspertë të turizmit

3.7 Triagulimi i të dhënave

Një metodë e rëndësishme e përdorur në kërkime cilësore është i njohur si triangulim i të dhënave. Triagulimi nënkupton përdorimin e më tepër se një metode kërkimi duke forcuar objektivitetin e punës kërkimore dhe dhe maksimizuar vlefshmërinë e tij (Flick, 1992).

Ka një debat të vazhdueshëm në lidhje me përdorimin e triangulimit. Disa studiues besojnë se ajo merr një qasje të ngushtë pozitive për interpretimin të lëndës, ndërsa të tjerë besojnë se ajo rrit thellësinë dhe gamën e të dhënave (Flick, 1992). Robson (2002) thekson se kjo është veçanërisht e rëndësishme në lidhje me të dhëna cilësore, pasi ajo mund të sigurojë besueshmërinë e të dhënave të mbledhura

Yin (2003) nënvizon se të dhënat e triangulimit përfshijnë informacionin e mbledhur nga burime të shumta me qëllim vërtetimin e të njëjtin fakt apo dukuri me qëllim që të rritet besimi i interpretimeve (Stake, 1995) Metodot e hulumtimit më së shpeshti lidhen me rastet e studimit, si vëzhgues, intervista dhe shqyrtimin e dokumenteve (Stake, 1995; Bassey, 1999; Yin 2003) janë përdorur për të mbledhur të dhëna. Në vijim ofron një pasqyrë të metodave të përdorura gjatë çdo fazë të punës në terren.

3.8 Modeli i krahasimit të profilit të “ *Port of Call*”

Krahas metodave të mësipërme gjatë punimit janë marrë në konsideratë praktikat e mira për zhvillimin e porteve në funksion të anijeve turistike dhe sidomos shndërrimin e tyre në pika të rëndësishme takimi në zonën e Adrionit.

Rasti i porteve të Venecias, Dubrovnikut dhe portit të Pireut dhe tarifave ndryshme portuale në funksion të këtij sektori. Krahasimi i tarifave të porteve është pjesë e hulumtimit e cila ndihmon dhe në krijimin më vonë të modellit të menaxhimit dhe marketingut në të ardhmen për portin e Durrësit.

Gjithë kësaj morie elementësh mungojnë dhe hulumtimet në arkivat e shtetit përse i përket historikut të lëvizjes së anijeve turistike në territorin shqiptar.


Në përfundim rezultatet dhe rekomandimet bëhen pjesë e analizës së zhvillimit në të ardhmen.

Modeli konceptual, i paraqitur në figurën e mëposhtme, për vetë kompleksitetin që paraqet, është ndërtuar duke u bazuar në tre elementë bazë.

- Elementi kryesor (majtas) përcakton lidhjen mes **Atraktivitetit të destinacionit** dhe **Kritereve të përzgjedhjes së tij** parë nën këndvështrimin e stakeholderave, duke e vëzhguar në nivel global, nivel rajonal (Adrionit) dhe në nivelin lokal (Porti i Durrësit);
- Elementi dytësor (djathtas) përfshin **Këndvështrimin e aktorëve kombëtarë dhe lokalë** të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në sektorin e turizmit të udhëtimit të anijeve turistike;
- Elementi i tretë është **Profili i udhëtarëve** që aktualisht kanë vizituar destinacionin e marrë në shqyrtim (portin e Durrësit).

Elementi bazë i modelit bazohet në modellin e përgjithshëm të konkurrueshmërisë së destinacionit zhvilluar nga Crouch & Ritch (1999) i përmirësuar prej tyre (2000) dhe më vonë në 2003 i cili konsiderohet si modeli më i njohur konceptual i konkurrueshmërisë në literaturën turistike.

Fig. 3.2 Skema konceptuale e punimit



KAPITULLI IV

STUDIMET KRAHASUESE ME PORTET E RAJONIT DHE RASTI I DURRËSIT

4.1 Modeli i konkurrueshmërisë ndërportuale për ankorimin e anijeve turistike

Analiza e konkurrueshmërisë ndërportuale, për arsye të pritjes dhe ankorimit të anijeve turistike, realizon një analizë krahasuese të kapaciteteve logjistike të porteve të rajonit, e më specifikisht të zonës së Adriatikut.

Portet konkurrojnë me njëri-tjetrin me qëllim që të përfshihen në itineraret e organizuara nga një ose disa marka të njohura të anijeve turistike. Megjithatë, jo të gjithë konkurrojnë për të njëjtin çmim. Zhvillimi i segmenteve të dallueshme të tregut (p.sh bashkëkohore, premium, luksoze) do të thotë se disa porte janë targetuar ose me zgjedhje, ose për shkak të kapacitetit dhe kufizimeve të destacionit, një pjesë e disa prej këtyre segmenteve më tepër se të gjithë. Konkurrenca është më intensive mes porteve të të njëjtës kategori. Linjat e lundrimit janë të interesuar në krijimin e itinerareve që përfshijnë portet e madhësive të ndryshme, pasi çdo port ofron përvoja të ndryshme, atraksione të ndryshme.

Konceptet e reja të zhvillimit të turizmit në kuadër të EUSAIR marrin në konsideratë pikërisht potencialet konkurruese dhe bashkëpunuese të porteve, kryesisht për krijimin e itinerareve të reja të turizmit dhe turizmit detar, të ndërthurur me atë në brendësi të territorit.

Figura 4.1 Portet në sherbim të anijeve turistike në zonën e Adriatikut
Burimi: Risposte Turismo Adriatic Sea Tourism Report (2016)



Portet detare janë arteriet kryesor të furnizimit të ekonomisë Shqiptare si dhe portat e komunikimit me pjesën tjetër të rajonit dhe botës (Metalla 2013). Sipas Notteboom dhe Wikenlams (2001), portet përbëjnë dhe një element jetësor të zinxhirit të furnizimit dhe shpërndarjes, por jo vetëm të produkteve të gatshme por dhe vizitorëve në destinacione.

Gjatësia e kalatës, madhësia e terminalit, ritmi i zënies së kalatës, vendndodhja gjeografike janë variabla të cilët ndikojnë në performancën e portit. Song (2001), Trujillo dhe Heng (2005) e lidhin performancën portuale me reformat dhe me ndryshimet teknologjike të cilat kanë ndodhur në vende të ndryshme si Azi, Evrope, Kore, Australi, Meksikë e Spanjë.

- Ekzistenca e avantazheve krahasuese të kostot
- Një ambient i favorshëm fiskal
- Paketa të përshtatshme incentivash për investitorët e huaj
- Programe mbështetëse për zhvillimin e burimeve njerëzore

Për analizimin e konkurrueshmërisë së portit të Durrësit dhe porteve të tjerë të zonës së Adriatikut kemi marrë në shqyrtim portet e Venecias, Dubrovnikut, Pireut dhe kemi sjellë dhe praktikën më të mira nga këto porte për të përkthyer funksionimin si porte turistike. Jo pa qëllim është realizuar kjo përzgjedhje duke marrë në konsideratë portin e Venecias, me numrin më të madh të prekjeve, por dhe me kundërshtimet më të shumta për të përkthyer këtë sektor të turizmit. Merret në konsideratë, porti i Dubrovnikut, me një zhvillim relativisht të ri në drejtimin e fluksit të anijeve turistike, duke marrë parasysh ndryshimet të cilat ndodhën vetëm 15 vjetë më parë në zhvillimin e turizmit në këtë qytet, i quajtur ndryshe "Perla e Adriatikut". Porti i tretë i marrë në shqyrtim, është porti i Pireut, i konsideruar një nga portet më të rëndësishme në bregdetin grek, por që vitet e fundit, sidomos pas fillimit të krizës ekonomike, u fokusua më tepër në menaxhimin e turizmit detar e kryesisht të anijeve turistike, pas ndryshimeve të rëndësishme logjistike.

Analiza lidhet drejtpërdrejtë me performancën portuale e cila për më shumë se 30 vite studiohet nga studiuesit portuale edhe pse konsiderohet në stade modeste. Metoda të ndryshme janë përdorur për matjen e performancës portuale, por shumë më pak të tilla janë përdorur për të matur performancën e porteve lidhur me levizjen e vizitorëve të anijeve turistike.

Suksesi komercial i një porti mund të rrjedhë nga një avantazh prodhues në shërbimet tradicionale, gjatë përpunimit të ngarkesës, nga shërbimet me vlerë të shtuar (ku hyjnë ankorimi i anijeve turistike), ose nga kombinimi i të dyjave. Ndryshimi teknologjik ka ndikuar pozitivisht në këtë tendencë nëpër vite, duke bërë që një pjesë e porteve realizuan shërbimet duke dhënë një vlerë të shtuar pikërisht për këtë element të udhëtimeve turistike. Portet mund të përjetojnë përfitime si-energji nga qendrat logjistike për të ofruar shërbime me vlerë të shtuar dhe kjo mund të konsiderohet si faktor suksesi sidomos në rastin e prekjeve nga anijet turistike.

Një vlerë e shtuar për portet konsiderohet dhe ekzistenca e pjesës së Hiterland, sidomos në rastin e krijimit të avantazheve konkurruese në krijimin e shërbimeve cilësore kundrejt pasagjerëve.

Hiterland portual kuptohet: *Zona tokësore e ndodhur në afërsi të një porti ose brenda kufirit të portit dhe që funksionon në mënyrë interactive dhe ngushtësisht me një port duke siguruar aktivitete biznesi, pavarësisht se kjo zonë është apo jo nën juridiksionin administrativ të autoritetit portual (Metalla, 2013).*

Avantazhi konkurrues është marrë në shqyrtim fillimisht nga Harris dhe Ogbonna (2001). Sipas Porterit (1985) i cili propozoi 5 forcat kryesore të avantazhit konkurrues, konkurrueshmëria është baza e suksesit apo dështimit të një biznesi. Në fushën e turizmit, cilësia e shërbimit, konsiderohet si një faktor i rëndësishëm i cili ka akoma rol më të rëndësishëm sepse influencon sjelljen e konsumatorit. Megjithatë një mënyrë e re e vlerësimit të avantazhit konkurrues, sidomos për destinacione të veçanta, është nëpërmjet një marketingu të kujdejsishëm dhe brandimit (Anholt 2007), Huang, Busby dhe Bosdou (2009), duke krijuar një imazh dhe reputacion për një zonë të vecantë.

Bizneset/vendet kanë nevojë të zgjedhin me kujdes strategjinë e tyre në mënyrë që të sigurojnë avantazhin konkurrues. Chang dhe Liu (2009) sugjerojnë se fokusi duhet të vendoset tek zhvillimi i aktiviteteve konkurruese, i cili është shumë i rëndësishëm sidomos në portet tranzit (*Port of call*), atje ku dhe një tërësi variablash duhet të punojnë së bashku. Shumë e rëndësishme është të konsiderosh se shumë sektor punojnë së bashku dhe të tjerë sektor mund të ndikojnë kërkesën duke ndikuar në avantazhin konkurrues (Brouthers dhe Brouthers, 1997).³⁵

Qeveritë kanë influencën më të madhe në avantazhin konkurrues, nëpërmjet aspekteve të tilla si ligjet, tarifat dhe taksat (Chang, 2000). Qeveritë mund të ndihmojnë, në zona siç janë destinacionet portuale, duke rritur investimet, duke e bërë më të lehtë për linjat e anijeve turistike dhe visitorët për ti vizituar këto destinacione (Grossman, 2008)³⁶.

Kur linjat e anijeve turistike zgjedhin portin e ndalimit tranzit, ata marrin parasysh një sërë faktorësh³⁷, por midis tyre mund të zgjidhen ata të cilët drejtohen nga Këshilluesit e Lehtësirave të Infrastrukturës Publike- Private.

Mund të përmendim:

- 1- *Pozicionin e portit dhe distancat e lundrimit nga portet e tjere të një itinerari*
- 2- *Marka, apo vlera e aktiviteteve të vlefshme për pasagjerët*
- 3- *Siguria dhe komforti i visitorëve*
- 4- *Ekzistenca e taksave lokale*

Një port që nuk ka një vendndodhje apo akses më të mirë se sa një port tjetër, nuk ka predispozicionin të performojë më mirë edhe pse mund të jete i konkurueshëm në facilitete, shërbim apo taksa. Për të gjitha këto, duhet të merret parasysh afërsia gjeografike në portet e tjera të lundrimit. Komfortiteti i vendndodhjes gjeografike me kohën, preferencat e shpejtësisë me linjat e lundrimit, veçanërisht mundësia për t'u bërë pjesë në itinerare që përfshijnë disa porte është një parametër jetik, sidomos në zhvillimin e një porti. Sot kjo formulë rezulton nga fakti se anijet ideale udhëtojnë në 18 nyje për 14 orë. Kjo do të thotë se distanca maksimale gjatë natës është 252 milje detare, ndërsa me shpejtësi të lartë prej 20 nyje maksimumi brenda natës rritet me 280 milje detare.

³⁷ Janë listuar në pjesën e literaturës

Përvoja e pasagjerit është faktor i dytë në përcaktimin e performancës së porteve turistike. Variabla të tillë si koha e kaluar, fluksi gjatë hipjes dhe zbritjes, mungesa e rradhëve në procedurat, hapësira e zonës, dhe mirësjellja sjellin vlerësime pozitive nga ana e udhëtarëve. Koha e zbarkimit (procedurat me doganat dhe imigracionin) dhe koha minimale në të gjitha funksionet, janë tregues kyç të performancës nga perspektiva e përdoruesit të një porti. Vlerësimet e përvojës së pasagjerit konsiderohen si një tregues i performancës sepse "*thashethemi*" dhe *rekomandimet* janë të rëndësishme për të gjeneruar interes duke ndikuar në vendimet mbi planifikimin e itinerarit.

4.1.1 Menaxhimi i anijeve turistike në portin e Venecias

Porti i Venecias, konsiderohet një nga portet më të rëndësishme jo vetëm në rajonin e Adria-it, por edhe në pjesën e Mesdheut. I vendosur në brigjet e një prej qyteteve, më të vizituar të botës, çdo vit thërret rreth vetes një sërë linjash të anijeve turistike. Porti drejtuar nga Autoriteti portual ka krijuar në funksion të udhëtimeve turistike, Venezia Terminal Pasagjer, (VTP) me sipërfaqe 244.000 m². Venezia Terminal Pasagjeri S.p.a e krijuar në vitin 1997, menaxhon 10 terminale shumëfunksionesh, duke siguruar shpejtësi të lartë për secilën anije turistike e cila prek portin e Venecias. Falë investimeve të konsiderueshme (rreth 70 milion Euro), midis viteve 1997-2015, për të siguruar facilitetet e portit, duke ulur dhe ndikimin negativ në mjedis dhe sigurimin e komfortit dhe sigurisë, porti i Venecias, ka pritur nëpër vite rreth 26.9 milion pasagjer.

Gjithashtu, Autoriteti Portual i Venecias (APV) ka realizuar një sërë aktivitete për promovim dhe komunikim. Në vitin 2005, ka filluar projekti për realizimin e SIT (*Sistemi Informativ Territorial*) një portal dedikuar promovimit tregëtar të ofertës në ndalime portuale pranë klientëve aktualë dhe potencial. Për t'ju përgjigjur sfidës globale, AP ofron një ofertë llogjistike të integruar e cila propozon dhe komunikon në nivel botëror. Lider në realizimin e këtyre aktiviteteve, APV ka krijuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera si Ravena Terminal Pasagjer, Catania Cruise Terminal, Brindisi, etj.

Terminali i Pasagjerëve në Portin e Venecias, lejon ankorimin e anijeve turistike me një gjatësi maksimale 340 metra, duke lejuar qëndrimin jo më shumë se 24 orë. Siguron shërbimet si pilotazhin, riparim anijesh, furnizim me karburant, shërbim pastrimi anijesh, energji për anijen, zonë për parkim autobusësh (40 autobus dhe 2334 makina). Siguron shërbime imbarkimi dhe check-in pasagjerësh, shërbime informuese, për zonën etj.

Gjithashtu AP i përgjigjet sfidave të globalizimit në një ofertë llogjistike të integruar të një porti që propozon dhe komunikon në nivel botëror. Promovime në Seatrade Mediterran, Cruise and Ferry Convection duke realizuar një politik marketingu të Venecias në tregjet ndërkombëtare. Për të përmirësuar ofertat portuale, midis VTP dhe SAVE S.p.s (shoqëria e cila menaxhon aeroportin Marco Polo të Venecias) është realizuar në formë bashkëpunimi vertikal, duke aktivizuar shërbimin check-in paraprak, për fluturime charter. Të gjitha këto kanë si qëllim lehtësimin e fazës së tranzitit në aeroport duke promovuar destinacionin si "*problem free*", si për pasagjerët ashtu edhe për operatorët.

VTP, së bashku me CLIA dhe MedCruise kanë realizuar një udhëzues ku jepen në mënyrë shumë të detajuar rregullat, tarifatat, si dhe gjithë procedurat të cilat lehtësojnë procesin e ankorimit dhe guidës turistike.

Tabela 4.1: Tarifat portuale në funksion të anijeve turistike Venecia

<i>Cmime specifike për TVP</i>	Euro
Asistencë pasagjerësh	1500 euro / prekje
Asistence imbarkimi/ transit etj	
- Pasagjerët (Hene- Premte)	17,60 / pasagjer
- Pasagjer (shtune)	19,57 euro/ pasagjer
- Pasagjer (Te diele dhe Pushim zyrtar)	23,35 euro/ pasagjer
- Pasagjer në transit	7.59 euro/ pasagjer
- Pasagjer me qëndrim natën	3.8 euro/ pax ditë
- Pasagjer të cilët qëndrojnë natën nga e hëna deri të premte	1,9 euro / pax ditë
- Shërbimi i sigurisë	0.94 euro / pasagjer
- Shërbimi i imbarkimit	1.05 euro / pasagjer
- Shërbimi i bagazheve në kabine	2.1 euro/ pas
- Shërbim sigurie ndaj anijes	58.48 euro/ ora

Tutela e ambientit është një faktor i rëndësishëm për administrimin lokal që kërkojnë të mbrojnë territorin nga turistët dhe kjo vjen duke përdorur elementët e mëposhtëm.

- Ulja e fluksit të turistave
- Ulja e ngarkesës së rrugëve
- Fuqizimi i transportit intermodal
- Përdorimi intensiv i transportit hekurudhor dhe detar
- Promovimi i anijeve me një impact të ulët ambiental

Ndërkaq, lëvizjet e mëdha ambientaliste me emërtimin “Jo anijeve të mëdha³⁸”, të cilat rrezikojnë seriozisht jetën e banorëve por dhe trashëgiminë e pasur kulturore të lagunës së Venecias, kanë bërë që ndër vite, masat e marra të jenë të shumta në favor të përmirësimit të cilësisë së jetës së banorëve të qytetit.

4.1.2. Menaxhimi i anijeve turistike në Portin e Dubrovnikut

Dubrovniku me rreth 42 mijë banorë siguron sot rreth 4 milion vizitor në vit, ku një pjesë e rëndësishme e tyre janë pjesë e turizmit detar (jahte, anije turistike etj). Ky ndryshim ka filluar ndjeshëm pas ndërhyrjes së investimeve të Bankës Botërore, të cilat kanë rritur dhe kapacitetin ankorues të portit të Dubrovnikut.

Dubrovniku është një port shumë funksional i cili vepron në sektorë të ndryshëm si: trafik mallrash, trafik pasagjerësh dhe aktivitet industrial. Luan kryesisht rolin e *port of call* për anijet turistike në Mesdhe dhe kompanitë të cilat e përdorin në tepër janë Royal Caribbean, Costa Crociere, MSC Crociere etj. Menaxhimi i është besuar APN e cila transformoi waterfroant

³⁸ NO, Grande Navi

portual me anë të marreveshjes me A.P dhe Holding Publik.Realizon një program “*Dubrovnik në dimër*” i cili ofron aktivitete kulturore, evente për turistë të cilët vizitojnë qytetin.

Ky program është një iniciativë nga Bordi Turistik i Dubrovnikut i përbërë nga Bashkia e qytetit dhe 66 biznese turistike.

Programi ofron Kartë dimërore (*Winter Card*) me shumë zbritje dhe hyrje falas në spektakle për turistët të cilët qëndrojnë minimalisht 2 netë në qytet (Service 2006).Gjithashtu një mbështetje i është dhënë sipërmarrësve të vegjël në qytet, si dhe ndërtimit të zonave të parkingut dhe ristrukturimin e portit.Porti funksionon në 3 sektor kryesor: linjat e anijeve turistike, jahte dhe turizmi detar, transporti lokal dhe transporti hekurudhor.

Gjatë viteve të fundit, Autoriteti Portual i Dubrovnikut, i kushtoi rëndësi studimit “*Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit të anijeve turistike në Kroaci*” realizuar nga Insituti i Turizmit, duke kërkuar të parashikojë dhe të kufizojë numrin e anijeve turistike.

Bazuar në faktin se fluksi turistik gjatë muajve të verës është rritur ndjeshëm,duke e parë destinacionin e Dubrovnikut si një nga destinacionet më të kërkuara në Mesdhe, janë marrë masa që numri i pasagjerëve në ditë të mos kalojë 8000 pasagjerë në ditë.Me një fluks prej 243 anijesh turistike në vit, vetëm 18 ditë mendohet se kalojnë numrin e tyre.Për të siguruar fleksibilitet në qytet, në marrëveshje me Autoritetin Portual është realizuar sistemi i prenotimeve, i cili përcakton qartë mundësitë e ankorimit por dhe monitorimin e hapësirave sidomos në ditët me ngarkesë maksimale.

Tabela 4.2 Tarifat portuale në funksion të anijeve turistike Dubrovnik

Burimi: Autoriteti Portual Dubrovnik

Ankorimi varet sipas gjatësisë	
Cmimi i ujit	4.5 euro/m kub
Cmimi per bagazh per pasx	5 euro/ pax
Asistencë pasagjerësh	1100 euro / prekje
- Pasagjer në transit	5.8 euro/ pasagjer
- Pasagjer me qëndrim natën	6.7 euro/ pax ditë
- Shërbimi i sigurisë	0.65 euro / pasagjer
- Shërbimi i imbarkimit	1.25 euro / pasagjer

4.1.3. Menaxhimi i anijeve turistike në portin e Pireut

Porti i Pireut është një destinacion i rëndësishëm për anijet turistike në detin Mesdhe.Hapësira portuale përmban 11 kalata për ankorimin e anijeve ku në 4-5 prej tyre mund të akomodohen dhe anijet turistike më të mëdha të momentit.

Porti operon me Terminalin e pasagjerëve i vendosur në funksion të turistëve, duke siguruar këtu dyqane duty free, pjesën e monitorimit nga Policia dhe zyrat doganore, si dhe shumë shërbime të nevojshme per pasagjerët.Në afërsi ndodhet një zonë parkimi e hapur në funksion të transportit të pasagjerëve.

Autoriteti Portual Pire (APP), ka si objektiv tërheqjen e sa më shumë pjese tregu nga udhëtimet e anijeve turistike. Pasagjerët mund të vizitojnë Pireun por mund të vizitojnë dhe Athinën e cila gjendet vetëm 30 minuta larg në një udhëtim realizuar me metro.

Autoritetet portuale në Pire, së bashku me ministrinë e Turizmit, i kanë shtuar përpjekjet për të realizuar itinerare eskursionesh sa më tërheqëse si dhe rritur aktivitet në momentin e pritjes së anijeve turistike. Për pjesën dërrmuese të udhetimeve realizohen programme të pasur me elementë kulturor me identitet kombëtar.

Tabela 4.3 Tarifat portuale në funksion të anijeve turistike Port i Pireut

Burimi: Autoriteti Portual Pire

Ankorimi varet sipas gjatësisë	
Cmimi i ujit	3.5 euro/m kub
Cmimi per bagazh per pasx	4 euro/ pax
Asistencë pasagjerësh	1300 euro / prekje
- Pasagjer në transit	4.8 euro/ pasagjer
- Pasagjer me qëndrim natën	5.7 euro/ pax ditë
- Shërbimi i sigurisë	0.65 euro / pasagjer
- Shërbimi i imbarkimit	1.35 euro / pasagjer

4.2 Shqipëria dhe portet pritëse të anijeve turistike

Shqipëria është një vend bregdetar me një pozicion gjeografik favorizues në Mesdhe. Në 28.748 km² sipërfaqe toke me shtrirje nga veriu në jug, me 340 km vijë ajrore, Shqipëria ofron befasi dhe larmi të madhe të peisazheve, të cilat ndryshojnë nga fushat bregdetare, në malet e larta, terrenet e thyera, liqenet e mëdhenj e të vegjël, lugina spektakolare të lumenjve, pyjet, etj.

Klima është mjaft e favorshme për të mbështetur çdo lloj aktiviteteve turistike, pasi Shqipëria veçon për numrin e madh të ditëve me diell. Llogaritet që 80 – 90% e ditëve të vitit janë me diell, ose mesatarisht 2200 orë. Falë kësaj klime, sezoni i plazhit zgjat nga 4-5 muaj në vit.

Bregdeti i Shqipërisë laget nga deti Adriatik një gjatësi bregdeti rreth 268km dhe nga deti Jon me një gjatësi bregdeti prej 150 km.

Roli i detarisë në sistemin ekonomik të vendit tonë është shumë i rëndësishëm dhe bazë e zbatimit të qëllimeve strategjike për ringjalljen e bregdetit dhe të gjithë aktiviteteve që lidhen me detin, administratën detare, portet, kompanitë e shërbimeve detare dhe deri te turizmi dhe peshkimi, për një integrim të suksesshëm të vendit tonë në detarinë evropiane.

Shqipëria ka katër porte kryesore që janë: Porti i Durrësit, porti i Vlorës, Porti i Shëngjinit dhe porti i Sarandës. Për qëllime studimi do të analizojmë më tepër portin e Durrësit dhe do përfshijmë deri një farë mase portin e Sarandës, si porte në funksion të turizmit të anijeve turistike.

Turizmi në Shqipëri

Fillimet e turizmit në Shqipëri konsiderohen pas viteve '90. Turizmi filloi pak nga pak, të mos konsiderohej më si një sektor pa ndikim në GDP (Licaj dhe Molla, 2011). Investimet private filluan të shfaqen në formën e investimeve në sektorin e HORECA.³⁹

Me kalimin e viteve, maturimi i tregjeve është shoqëruar me rritjen e fluksit të vizitorëve nga viti në vit. Sot sektori i turizmit në Shqipëri paraqet oportunitete të shumta, si për biznesin i cili është përfshirë në aktivitete të ndryshme në shërbim të turistëve, ashtu edhe për sektorin publik i cili përfiton nga rritja e të ardhurave nga turizmi dhe investimeve në këtë sektor.

Numri i vizitorëve të huaj, jo vetëm emigrantëve shqiptarë jorezidentë por dhe vizitorëve me nënshtetësi të huaj është rritur ndjeshëm, falë edhe potencialit turistik dhe ofertës së diversifikuar që ekziston në territorin shqiptar me cmime konkurruese.

Nëse u referohemi shifrave, numri i vizitorëve të huaj për vitin 2015-të arriti në 3.945.000, ose 13.8% më shumë në krahasim me një vit më parë (3,467,765). Trendi vazhdon të rritet duke evidentuar se për tremujorin e parë të vitit 2016-të kemi një rritje prej afërsisht 14 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2015.

Të ardhurat nga turizmi gjatë vitit 2015 kanë arritur në 1.352.000 Euro duke shënuar një rritje prej 5 % në krahasim me një vit më parë, ndërsa kontributi direkt i turizmit në GDP-në e vendit ka qenë 87.6 miliard lekë, ose 6% e GDP-së. Gjatë vitit 2015 industria e turizmit ka gjeneruar në mënyrë direkte 51.000 vende pune (5.5% e totalit të vendeve të punës), ose 1400 vende pune më shumë krahasuar me 2014.

Turizmi si një fenomen ndërsektorial, kërkon koordinimin dhe bashkëveprimin e të gjithë aktorëve dhe grupeve të interesit, duke filluar me pushtetin qendror dhe pushtetin e vetëqeverisjes vendore, sipërmarrjet turistike si edhe të gjitha institucionet publike dhe private të edukimit, që kontribuojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e këtij sektori me rëndësi strategjike për vendin.

4.3. Durrësi dhe trashëgimia kulturore

4.3.1 Vështrim gjeografik mbi Durrësin

